



RAPORTI PËR KORRUPSIONIN NË FUSHËN E MJEDISIT JETËSOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

RAPORTI PËR KORRUPSIONIN
NË FUSHËN E MJEDISIT
JETËSOR NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT

Titull: Raporti për korrupsionin në fushën e mjedisit jetësor
në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Autore: Jugosllava Dukovska
Eksperte vendase

Përktheu në shqip: Fatos Kica

Redaktim gjuhësor: BESTEL SHPKNJP Shkup

ISBN 978-92-9271-004-0

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Materialet në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse Misioni i OSBE-së në Shkup ka përkushtuar kujdesin më të madh në zhvillimin e tij, i njëjti nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

Përmbajtja

I. HYRJE.....	7
II. KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR	9
II.1. Korniza ligjore nacionale për mbrojtjen e mjedisit jetësor	9
II.2. Vendosja institucionale e mbrojtjes së mjedisit jetësor	11
II.3. Korniza ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit jetësor.....	14
II.4. Dokumente strategjike për mjedisin jetësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut	17
III. KORNIZA JURIDIKE PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT	19
III.1. Korniza nacionale juridike për luftë kundër korrupsionit	19
III.2. Dokumente strategjike në luftën kundër korrupsionit	21
III.3. Korniza ndërkombëtare juridike për luftë kundër korrupsionit.....	22
III.4. Transparenca si parim kryesor në luftën kundër korrupsionit në fushën e mjedisit jetësor	26
IV. ANALIZA E FUSHAVE TË MJEDISIT JETËSOR QË PREKEN LEHTË NGA KORRUPSIONI.....	34
IV.1. Cilësia e ajrit	35
IV.2. Burimet e ujit dhe e drejta e ujit.....	36
IV.3. Menaxhimi i pyjeve	38
IV.4. Zonat e mbrojtura	39
IV.5. Dhënia e lejeve për shfrytëzim, respektivisht eksploitim	40
IV.6. Inspektimi dhe kontrolli.....	47
IV.7. Përfshirja e publikut si formë kontrolli	50
IV.8. Perspektiva gjinore në luftën kundër korrupsionit në mjedisin jetësor.....	53
V. REKOMANDIME.....	56
VI. BURIME TË SHFRYTËZUARA	59

I. HYRJE

Një nga fushat që janë jetike për cilësinë dhe jetën e shëndetshme të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është mjedisi i pastër dhe i shëndetshëm. Ky fakt është përfshirë në të drejtat themelore të qytetarëve të saj në Kushtetutën e shtetit, brenda Nenit 43:

Gjithkush ka të drejtën për një mjedis jetësor të shëndetshëm. Gjithkush ka për detyrë të promovojë dhe mbrojtë mjedisin jetësor dhe natyrën. Republika siguron kushte për të ushtruar të drejtën e qytetarëve për një mjedis jetësor të shëndetshëm.

Megjithatë, ekzistojnë tregues të shumtë se në Republikën e Maqedonisë së Veriut mjedisi jetësor është i rrezikuar, dhe rrjedhimisht rrezikohen edhe shëndeti dhe jeta e qytetarëve të saj.

Procesi i përshtatjes së legjisllacionit të brendshëm në fushën e mjedisit jetësor me atë të Bashkimit Evropian zhvillohet që njëzet vite dhe ligjet e miratuara që rregullojnë fushën e mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit jetësor janë në fuqi për më shumë se një dekadë. Në praktikë, ekziston një mospërputhje e dukshme midis asaj që thuhet në ligje dhe në deklaratimet publike të përfaqësuesve shtetërorë për një përkujdesje më të madhe dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit jetësor, nga njëra anë, dhe realitetit, nga ana tjetër – gjë që konstatohet në shumë raporte vendase dhe ndërkombëtare.

Mbrojtja e mjedisit jetësor prej vitesh përfshihet edhe në programet e partive politike dhe të pushtetit ekzekutiv në nivelin qendror dhe lokal; madje ekzistojnë dhe funksionojnë institucione, detyra kryesore e të cilave është mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit jetësor, dhe rrjedhimisht parashtrohet pyetja: ku është pengesa për realizimin e planeve dhe premtimeve të planifikuara për ruajtjen e natyrës së pastër, ajrit të shëndetshëm, tokës dhe ujit të pandotur, për mbrojtjen dhe avancimin e gjendjes së rariteteve dhe bukurive natyrore, disa prej të cilave njihen si pjesë e trashëgimisë natyrore botërore?

Ky hulumtim bazohet në gjetjet dhe komentet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për anëtarësim në BE, në kapitullin mbi mjedisin jetësor, dokumentet ndërkombëtare dhe deklaratat për luftën kundër korrupsionit dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe në legjisllacionin e brendshëm mbi korrupsionin dhe Strategjinë Nacionale për luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit për periudhën 2021-2025 dhe Planit të Veprimt për të njëjtën periudhë. Ky raport shqyrton legjisllacionin aktual që rregullon mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe ligjet që rregullojnë fusha të ndryshme në

fushën e mbrojtjes së natyrës, ndotjes së mediave natyrorë dhe inspektimit, e të cilat akoma nuk janë miratuar.

Në aspekt metodologjik, për nevojat e këtij studimi u krye një hulumtim dhe u bënë disa intervista me persona të rëndësishëm të kësaj fushe – përfaqësues të iniciativave qytetare, si dhe me një pjesë të publikut të prekur. Për nevojat e hulumtimit u shfrytëzuan informata me të cilat dispononin ueb-faqet zyrtare të ministrive dhe komunave, si dhe informata nga paraqitjet në tribuna që temë trajtimi kanë pasur korrupsionin e mjedisit jetësor, raporte të organizatave që merren me cilësinë dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe kërkime gazetareske dhe histori mbi çështje ekologjike, të cilat tregojnë lidhshmëri me elementë të mundshëm korrupsioni.

Qëllimi i hulumtimit është të nxjerrë në sipërfaqe fushat në kuadër të mbrojtjes së mjedisit jetësor për të cilat ka indikacione se ekziston një rrezik më i madh korrupsioni dhe të japë rekomandime për hapat e ardhshëm me qëllim të zvogëlimit të atyre rreziqeve dhe përmirësim të gjendjes.

II. KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR

II.1. Korniza ligjore nacionale për mbrojtjen e mjedisit jetësor

Në nenin 43 të Kushtetutës së RMV e drejta për një mjedis jetësor cilësor dhe të shëndetshëm përcaktohet si një nga të drejtat themelore të qytetarëve, ku secili e ka për detyrë ta promovojë dhe mbrojtë mjedisin jetësor dhe natyrën.

Secili aspekt i mjedisit jetësor është përpunuar dhe zbërthyer në ligje të veçanta, që krijojnë sisteme mbrojtëse specifike për atë medium të veçantë natyror. Ligjet themelore që rregullojnë fushën e mjedisit jetësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë si më poshtë:

- Ligji për mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare, nr.53/05,81/05,24/07,159/08, 83/2009, 124/2010, 51/2011, 123/12, 93/13, 187/13 42/14, 44/15 129/15, 192/15, 39/16, 99/18);
- Ligji për mbrojtjen e natyrës (Gazeta Zyrtare e RM, nr.67/04, 14/06, 84/07, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13, 41/14 dhe 146/15);
- Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit (Gazeta Zyrtare e RM, nr.67/04 92/07, 35/10, 47/11, 59/12, 163/13, 10/15, 146/15);
- Ligji për menaxhimin e mbeturinave (Gazeta Zyrtare e RM, nr.68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 134/08, 124/10, 51/11, 123/12, 147/13, 163/13, 51/15, 146/15, 192/15);
- Ligji për ujërat (Gazeta Zyrtare e RM, nr.87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13, 180/14, 146/15);
- Ligji për menaxhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike (Gazeta Zyrtare, nga 13.01.2012);
- Ligji për pyje (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 47/97 nga 19.09.1997);
- Ligji për planifikim urban (Gazeta Zyrtare, nr.32/2020 nga 10.02.2020);
- Ligji për mbrojtje nga zhurma në mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare e RM, nr.79/2007, 124/2010 dhe 47/2011).

Megjithatë, disa prej ligjeve të cilat rregullojnë aspekte të rëndësishme të mbrojtjes së mjedisit jetësor nuk janë miratuar ende, edhe pse disa prej tyre janë përgatitur prej kohësh dhe duhet të kishin hyrë në procedurë parlamentare. I tillë është Ligji për inspektimin e mjedisit jetësor, i përgatitur që në vitin 2015, dhe për këtë problem është shkruar edhe në raportet e KE të vitit 2019¹ dhe vitit 2020². lidhur me përparimin e vendit në rrugën për anëtarësim në BE. Përveç këtij ligji, nuk është miratuar as Ligji për emetimet industriale, i hartuar në përputhje me Direktivën Evropiane për Emetimet Industriale nga viti 2010, e as Ligji për tokat bujqësore.

1 <https://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Izveshtaj%202019-F.pdf> faqe 100

2 https://www.sep.gov.mk/page/?id=1117#.YC_tpOhKg2w, faqe 108

Një nga ligjet më të rëndësishme që rregullon fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor është Ligji për mjedisin jetësor, i miratuar në vitin 2005. Ai rregullon të drejtat dhe detyrimet e shtetit, vetëqeverisjes lokale dhe qytetarëve, në sigurimin e kushteve për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor. Qëllimet e tij janë ruajtja, mbrojtja, restaurimi dhe promovimi i mbrojtjes së mjedisit jetësor, mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve, mbrojtja e biodiversitetit, përdorimi racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore, si dhe zbatimi i masave për zgjidhjen e problemeve globale ekologjike. Një nga parimet më të rëndësishme të përfshira në këtë ligj është procedura për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor (VNMJ) dhe procedura për vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedisin jetësor (VSMJ) të disa strategjive, planeve dhe programeve, të cilat parashohin masa dhe aktivitete për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës (neni 76). Me këtë, në Ligjin për mjedisin jetësor transpozohet Direktiva e Bashkimit Evropian për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor (Direktiva e VNMJ 85/337/KEE, e ndryshuar nga Direktivat 97/11/KEE dhe 2003/35/KE). Ajo përcakton kushtet për kryerjen e vlerësimeve për ndikimet e mundshme mbi mjedisin jetësor të projekteve publike dhe private, që supozohet se do të kenë një ndikim të theksuar në mjedisin jetësor. Prandaj, VNMJ duhet të kryhet përpara dhënies së pëlqimit për fillimin e projekteve të caktuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i procesit të VNMJ është që të parashikojë ndikimet e mundshme dëmtoese mbi mjedisin jetësor dhe të shmangë ose zvogëlojë ndikime të tilla të dëmshme, gjatë balancit të objektivave ekologjike, ekonomike dhe sociale.

Ligji për mbrojtjen e natyrës nga viti 2004 përcakton parimet themelore të mbrojtjes së natyrës, në bazë të të cilave rregullohen procedurat e duhura për menaxhimin e saj. Qëllimet kryesore të këtij janë:

1. Të konstatojë gjendjen e natyrës dhe të bëjë vëzhgimin e saj;
2. Të ruajë dhe restaurojë llojllojshmërinë aktuale biologjike dhe larminë e peizazhit në një gjendje të ekuilibrit natyror;
3. Të formojë rrjetin e zonave të mbrojtura, me qëllim të mbrojtjes së përhershme të veçorive në bazë të të cilave kanë përfituar statusin e trashëgimisë natyrore;
4. Të mundësojë shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurisë natyrore, në interes të zhvillimit momental dhe të ardhshëm, pa dëmtuar dukshëm pjesët e natyrës dhe duke minimizuar cenueshmërinë e ekuilibrit natyror;
5. Të parandalojë aktivitetet e dëmshme të personave fizikë dhe juridikë, dhe shkatërrimin e natyrës, si pasojë e zhvillimit teknologjik dhe veprimtarive që zhvillohen në të;
6. Të sigurojë kushte të volitshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e natyrës;
7. Të sigurojë të drejtën e qytetarëve për mjedis jetësor të shëndoshë.

Ligji për mbrojtjen e natyrës është ligji më i rëndësishëm që rregullon mbrojtjen e llojeve të egra të bimëve, kërpudhave dhe kafshëve, habitateve natyrore dhe ekosistemeve, si dhe mbrojtjen e peizazhit, mineraleve dhe fosileve. Një pjesë e veçantë e ligjit i referohet sistemit të zonave të mbrojtura, që është krijuar për të mbrojtur biodiversitetin brenda

habitateve natyrore, proceset që ndodhin në natyrë, si dhe karakteristikat abiotike dhe larminë e peizazhit. Ligji përmban dispozita lidhur me kategoritë e zonave të mbrojtura, mënyrën e shpalljes së tyre, ndarjen në zona dhe menaxhimin e tyre. Në këtë ligj janë transpozuar dispozitat e Direktivës së BE mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër (92/43/KEE), Direktivës së BE mbi ruajtjen e shpendëve të egër (2009/147/EC), si dhe Rregullorja për mbrojtjen e specieve të florës e faunës së egër përmes rregullimit të tregëtimit të tyre (338/97 EEC).

II.2. Vendosja institucionale e mbrojtjes së mjedisit jetësor

Në sistemin nacional për mbrojtjen e mjedisit jetësor janë të përfshira këto institucione:

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Harton, përcakton dhe zbaton politika, shpall dekrete dhe Kuvendit i propozon ligje dhe dokumente strategjike nga fusha e mjedisit jetësor, të cilat pastaj Kuvendi i miraton;

- **Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor** – Organ qendror i pushtetit ekzekutiv, përgjegjës për punët nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në vend;
- **Drejtoria e Mjedisit Jetësor** – Organ në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, përgjegjës për ushtrimin e kompetencave nga fusha e mbrojtjes dhe avancimit të mjedisit jetësor dhe natyrës. Përbëhet nga: Sektori për Natyrë, Sektori për Mjedis Jetësor, Sektori për Ujëra, Sektori për Mbeturina dhe Sektori për Ndotje Industriale dhe Menaxhim me Rreziqe;
- **Këshilli Inspektorial** – institucioni kyç në sistemin e mbikëqyrjes inspektoriale, që funksionon si organ i pavarur që nga viti 2014, rregullon punën e shërbimeve inspektoriale, ku bën pjesë edhe Inspektorati për Mjedis Jetësor. Përbëhet nga një kryetar dhe gjashtë anëtarë, mes të cilëve edhe një person përgjegjës për mjedisin jetësor dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, dhe nga një person përgjegjës për bujqësi, pylltari, veterinari dhe siguri ushqimore;
- **Inspektorati Shtetëror për Mjedisin Jetësor** – Organ qendror për kryerjen e mbikëqyrjes së rregullt dhe të jashtëzakonshme inspektoriale mbi zbatimin e masave teknike-teknologjike për mbrojtjen e ajrit, ujërave, tokës, florës dhe faunës nga degradimi dhe ndotja, mbrojtje të gjeodiversitetit dhe biodiversitetit, veçanërisht të pasurisë natyrore;
- **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU)** – ka rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të llojlojshmërisë biologjike, përmes sigurimit dhe zbatimit të masave për mbrojtjen e pyjeve, tokës dhe ujërave;
- **Ministria e Ekonomisë** – ka rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përmes kompetencave që ushtron Sektori për

Lëndë të Parë Minerale. Poashtu, përmes Sektorit për Energjetikë kjo ministri mund të luajë rol të rëndësishëm, duke siguruar masa për mbrojtje të natyrës;

- **Ministria e Transportit dhe Lidhjeve** - ka kompetenca të rëndësishme në ndërtimin e objekteve infrastrukturore, koridoreve rrugore, infrastrukturës turistike dhe të tjera, me ç'rast duhet të ketë parasysh ndikimin e këtyre aktiviteteve mbi natyrën dhe mbrojtjes së saj;
- **Inspektorati Shtetëror për Pylltari dhe Gjueti** - organ në kompetencat e të cilit është inspektimi i eksploatimit të pyjeve;
- **Policia e Pyjeve** - Organ në përbërje të MBPEU, për zbatimin e mbrojtjes së zonave pyjore nga vjedhja e druve;
- **Ndërmarrja Publike "Pyjet Nacionale"** - ndërmarrje shtetërore e cila kujdeset për fondin e pyjeve në vend;
- **Shoqata Nacionale e Pronarëve të Pyjeve Private** - shoqata e pronarëve të pyjeve private, të cilët janë jashtë kompetencave të NP Pyjet Nacionale.

Megjithëse kujdesi për mjedisin jetësor është përqëndruar kryesisht në nivel qendror, sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale nga viti 2002, edhe komnat kanë kompetenca të caktuara në këtë drejtim. Në nenin 22 thuhet se komnat kujdesen për:

"Mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës, gjegjësisht zbatimin e masave për mbrojtjen dhe parandalimin e ndotjes së ujit, ajrit, tokës, mbrojtjen e natyrës, mbrojtjen nga zhurma dhe rrezatimi jo-jonizues".

Sipas Ligjit për mjedisin jetësor, një komunë e caktuar, Qyteti i Shkupit dhe komnat në Qytetin e Shkupit do të shqiptojnë masë ndalimi për kryerjen e aktiviteteve dhe kthimin e mjedisit jetësor në një gjendje të kënaqshme. Këshillat komunale dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit e kanë për detyrë të informojnë publikun për rastet e tejkalimit të emetimeve të lejuara dhe për rastet e tjera të ndotjes së mjedisit jetësor, si dhe të miratojnë një akt të posaçëm për të ndërmarrë masa të detyrueshme (neni 26).

Sipas Ligjit për mjedisin jetësor, njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të detyruara që nga buxheti të sigurojnë mjete financiare për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor. Për shkak të situatës së vështirë financiare të shumë komunave, kujdesi për mbrojtjen e mjedisit jetësor kushtëzohet nga fondet që ato kanë në dispozicion, repektivisht gjendja e dobët financiare shpesh reflektohet në masat që ndërmerr vetëqeverisja lokale për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm jetësor.³

Përveç këtyre ligjeve, për kompetencat e vetëqeverisjes lokale në fushën e mjedisit jetësor ekzistojnë dispozita në kuadër të Ligjit për ajrin e ambientit, Ligjit për ujërat dhe Ligjit për mbrojtjen nga zhurma. Praktika na tregon se procedurat janë të centralizuara,

3 <http://nvoinfocentar.mk/wp-content/uploads/2020/04/lzvestaj-za-opstinskite-inspekciski-sluzbi.pdf>

sepse komunat, përveç miratimit të planeve lokale të veprimit ekologjik, të cilat duhet të ofrojnë aktivitete afatshkurtëra dhe afatmesme për mbrojtjen e mjedisit jetësor, e të cilat vështirë të zbatohen për shkak të problemeve financiare, vendosin vetëm për dhënien e lejeve të integruara ekologjike të kategorisë B për kapacitete industriale – Ndotës, që sipas ministrisë përkatëse nuk duhet të marrin leje të integruara ekologjike të kategorisë A, si dhe japin pëlqim për ato objekte industriale për të cilat është të vendosur t’u jepet leje e integruar ekologjike e kategorisë A. Komunat poashtu japin mendim edhe për projektet që duhet të realizohen në territorin e komunës, në bazë të studimit të përgatitur për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor dhe planifikimin hapësinor, dhe gjithashtu marrin pjesë në debatin publik. Ndërkaq, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për përgatitjen e studimeve. Edhe pse, nominalisht, kompetencat bazë të komunave përfshijnë miratimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të mbeturinave, miratimin e programeve për zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe cilësisë së ajrit të ambientit, si dhe parashohin pjesëmarrjen në miratimin dhe zbatimin e Programit Nacional për Ujin dhe Ekonominë e Ujërave, dhe miratimin e planeve për menaxhimin e organeve të pëllgjeve të lumenjve – zbatimin e këtyre kompetencave komunale kryesisht varet nga strategjitë dhe planet e zhvilluara dhe të hartuara në nivel qendror, gjegjësisht nga mosmiratimi i tyre prej autoriteteve qendrore.

Komunat e kanë për detyrë të kontrollojnë ndotësit e mundshëm me kapacitet më të vogël, të vendosur në territorin e asaj komune. Fushëveprimi i mbikëqyrjes nga inspektorët komunal është i kufizuar në madhësinë dhe llojin e ndotësit dhe ndotjes. Megjithatë, sipas të dhënave të siguruar nga Këshilli i Inspektimit⁴ vetëm 36 nga 81 komuna kanë inspektor të autorizuar të mjedisit jetësor.

II.3. Korniza ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit jetësor

Konventat më të rëndësishme ndërkombëtare nga fusha e mjedisit jetësor, të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë së Veriut:⁵

- Konventa për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor në kontekst ndërkufitar (Espo, shkurt 1991);
- Ligji për ratifikim (“Gazeta Zyrtare e RM”, nr.44/99) <http://www.unece.org/env/eia>
- Protokoli për vlerësim strategjik të mjedisit jetësor
Ligji për ratifikim (“Gazeta Zyrtare e RM”, nr.120/2013) http://www.unece.org/env/eia/sea_protocol.html
- Marrëveshja multilaterale mes vendeve të Evropës Juglindore për zbatimin e konventës për vlerësimin e ndikimeve mbi mjedisin jetësor në kontekst ndërkufitar

4 Shkresë e pranuar më 19.04.2021. Në shkresën e njëjtë thuhej se “duhet t’u drejtoheni komunave për arsyet pse dhe për sa kohë njësitë tjera të vetëqeverisjes lokale nuk kanë pasur inspektorë komunalë të mjedisit jetësor”.

5 https://www.moepp.gov.mk/?page_id=4200

Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.157/10) http://www.unece.org/env/eia/subregions/se_europe.html

- Konventa për qasje në informata, pjesëmarrjen e opinionit në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor (Arhus)
Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.40/99) <http://www.unece.org/environmental-policy/treaties/public-participation/aarhus-convention.html>
- Protokoli për Regjistër të ndotësve dhe transferimin e materieve ndotëse
Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.135/2010) <http://www.unece.org/env/pp/prtr.html>

Nga fusha e mbrojtjes së natyrës:

- Konventa për llojllojshmëri biologjike
Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.54/97) www.cbd.int
- Konventa për mbrojtjen e vendbanimeve ujore me rëndësi ndërkombëtare për mbrojtje të shpendëve ujorë (Ramsar)
Direktiva për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RSFJ", nr.9/77) <http://www.ramsar.org>
- Konventa për mbrojtjen e llojeve migruese të kafshëve të egra (Bon)
Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.38/99) <http://www.cms.int>

Nga fusha e mbrotjes së atmosferës:

- Konventa vieneze për mbrojtjen e shtresës së ozonit (Vienë, mars 1985)
Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RSFJ", nr.1/1990).
E ratifikuar nga RM më 10 mars, 1994.
http://ozone.unep.org/new_site/en/vienna_convention.php
- Protokoli i Montrealit lidhur me substancat që varfërojnë shtresë e ozonit ("Gazeta Zyrtare e RSFJ", nr.16/90).
Protokoli u ratifikua më 10.03.1994.
http://ozone.unep.org/new_site/en/montreal_protocol.php
- Amandamenti i Protokolit të Montrealit për substancat që varfërojnë shtresën e ozonit – Londër
Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.25/98)
http://ozone.unep.org/new_site/en/Treaties/treaties_decisions-hb.php?dec_id_anx_auto=780

Lidhur me ndryshimet klimatike

- Ligji për ratifikim i Amandamentit Kigali të Protokolit të Montrealit për substancat që varfërojnë shtresën e ozonit "Gazeta Zyrtare e RMV", nr.34/2020
- Ligji për ratifikimin e Amandamentit Doha të Protokolit të Kjotos ndaj Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për ndryshime klimatike "Gazeta Zyrtare e RM", nr.152/2019 nga 25.07.2019
- Ligji për ratifikim i Marrëveshjes nga Parisi "Gazeta Zyrtare e RM", nr.161/2017
- Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për ndryshime klimatike (Nju Jork, maj)
Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.61/97) <http://unfccc.int/2860.php>

- Protokoli i Kjos ndaj Konventës Kornizë të Bashkuara për ndryshime klimatike Ligji për ratifikim ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.49/2004)
http://unfccc.int/kyoto_protocol/items/2830.php

Çfarë thonë raportet evropiane për qasjen e pushtetit ndaj mjedisit jetësor?

Raportet e Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqesin tregues të rëndësishëm të suksesit të vendit dhe përshtatjes së standardeve të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës në kuadër të BE. Për nevojat e këtij hulumtimi janë analizuar katër raportet e fundit sepse gjetjet e tyre janë tregues të saktë për dobësitë e sistemit dhe për mënyrën e funksionimit të institucioneve shtetërore që kanë përgjegjësinë e mbrojtjes së mjedisit jetësor, për të sugjeruar se nëpër vite përvidhen mangësitë e njëjta dhe shpesh herë raportohet për problemet e njëjta. Në kontekst të kësaj, në Raportin për vitin 2020, konstatohet se *"ka dialog të vazhdueshëm me shoqërinë civile, por nevojiten përpjekje plotësuese për përmirësimin e qasjes në informata, pjesëmarrje të opinionit dhe konsultim të opinionit lidhur me proceset e marrjes së vendimeve"*.

Përhëndetet formimi i Qendrës së Arhusit, e para e këtij lloji në vend, që pritet të mbështesë pjesëmarrjen e opinionit lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Raporti i KE thotë se ekziston nevoja për të përmirësuar më tej vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe procedurat strategjike të vlerësimit të mjedisit jetësor, si dhe cilësinë e studimeve dhe proceset e konsultimit publik, sidomos për projekte lidhur me hidroenergji, miniera dhe infrastrukturë. Edhe në raportet e vitit 2016, 2018 dhe 2019 theksohet nevoja për përfshirjen e publikut në proceset e vendimmarrjes (veçanërisht në procedurat e vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor), nga e cila mund të konkludohet se parimi i përfshirjes së publikut që paraqet segment të rëndësishëm në proceset e vendimmarrjes për projekte që mund të kenë ndikim në mjedisin jetësor, nuk është zbatuar gjatë viteve, pavarësisht udhëzimeve të Bashkimit Evropian, dhe edhe më tej mbetet një problem. Jotransparenca e këtyre procedurave, për të cilat parashihet pjesëmarrja e publikut, ngre dyshime se disa projekte me rëndësi publike mbahen qëllimisht larg vëmendjes së publikut.

Pika e dytë e rëndësishme në Raportin e vitit 2020 është se Ligji për inspektimin e mjedisit jetësor, i cili është pjesë e ligjeve për mjedisin jetësor që akoma nuk janë në fuqi, duhet të miratohet sa më parë. Kjo mungesë përmendet gjithashtu edhe në raportet e mëparshme të Komisionit Evropian. Nevoja për këtë ligj buron nga nevoja për planifikim shumëvjeçar të koordinuar të inspektimit në nivel qendror dhe lokal, që do të monitorojë qëllimet dhe prioritetet strategjike

afatgjata, të përfshira në dokumentet strategjike nga fusha e mjedisit jetësor, si dhe planifikimin e inspektimit në pajtim me kriteret e përcaktuara për vlerësimin e rrezikut dhe në përputhje me ndikimin që kanë subjektet mbikëqyrëse mbi mjedisin jetësor.⁶

Raporti i KE për vitin 2020 gjithashtu flet për gjendjen lidhur me mbrojtjen e Ohrit, duke përshëndetur faktin se janë ndërmarrë disa hapa për të zbatuar Konkluzat e UNESCO-s mbi trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit të Ohrit, por konstaton se ende duhen përpjekje të konsiderueshme, sidomos për të parandaluar përfshirjen e tij në Listën e trashëgimisë botërore të rrezikuar.

Në fillim të vitit 2021, opinion publik u informua për përmbajtjen e Draft-Raportit të Misionit të Dytë Reaktiv të UNESCO-s (edhe pse ai nuk u bë publik, por pjesë të tij u zbuluan jozyrtarisht në disa media). Në dispozicion të publikut është vetëm raporti i Ministrisë së Kulturës, si seli e Komisionit Nacional për UNESCO, i cili shqyrton vërejtjet e UNESCO-s⁷) Ai raport jep vërejtje serioze për pushtetin qendror dhe lokal se ato nuk kanë përmbushur shumicën e detyrimeve në lidhje me zbatimin e udhëzimeve të dhëna në raportin paraprak të UNESCO-s, e i cili raport mund ta vendosë Ohrin në listën e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rrezik.

II.4. Dokumente strategjike për mjedisin jetësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Disa dokumente të rëndësishme strategjike rregullojnë fushën e krijimit të politikave për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit jetësor, për zbatimin e të cilave përgjegjëse është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:

- **Strategjia Nationale për mbrojtjen e natyrës (2017-2027)**, që buron nga nevoja për të përmirësuar kushtet lidhur me mbrojtjen e gjeodiversitetit dhe gjeotrashëgimisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, diversitetit biologjik dhe të peizazhit, si dhe tokës, ujit dhe ajrit. Qëllimi i saj është zbatimi më efikas i legjislacionit nacional dhe detyrimeve nga legjislacioni i BE-së, respektivisht zbatimi i direktivave të BE-së mbi habitatet dhe shpendët, tre konventave kornizë të OKB-së (Konventa për mbrojtjen e diversitetit biologjik, Konventa për ndryshimet klimatike dhe Konventa për Shkretëtirëzimin), si dhe të dokumenteve tjera të ratifikuara ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së natyrës.

6 <https://akademik.mk/se-podgotvuva-nov-zakon-za-inspeksija-vo-zhivotnata-sredina/>

7 http://kultura.gov.mk/wp-content/uploads/2021/02/Izvestaj-za-sostojbata-so-zastitata-Ohridski-Region_spoen.pdf

- **Strategjia Nationale për biodiversitet (2019-2023)** Zhvillimi i një Strategjie me plan veprimi paraqet një proces përmes të cilit vendet planifikojnë veprimet e nevojshme për të kapërcyer pengesat për ruajtjen e biodiversitetit dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme. Konventa e OKB-së mbi llojlojshmërinë biologjike obligon të gjitha shtetet të zhvillojnë strategji nacionale dhe të paraqesin rregullisht raporte nacionale me informata për masat që janë ndërmarrë lidhur me zbatimin e Konventës.
- **Strategjia Nationale për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike (2014-2020)** që buron nga nevoja për të përcaktuar qëllimet dhe prioritetet e politikave në fushën e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike për periudhën 2014-2020, që do të çojnë në përmirësimin e cilësisë së mjedisit jetësor dhe jetës së qytetarëve. Periudha implementuese e kësaj strategjie ka skaduar dhe duhet të zhvillohet një e re.
- **Strategjia Nationale për zhvillim të qëndrueshëm (2009-2030)** bazohet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të pranuara në nivel global dhe të përcaktuara në Konferencën e OKB-së për mjedisin jetësor dhe zhvillim (Rio de Zhaneiro, 1992), në mënyrë që Agjenda 21 të jetë operacionale. Poashtu ajo bazohet edhe në Deklaratën dhe Planin e Zbatimit – Johaneshburg 2002, të miratuara në Samitin Botëror mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm, në lidhje me parimet e Deklaratës së Mijëvjeçarit të KB të përfshira në Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit dhe parimet e zhvilluara në Strategjinë e ripërtërirë të BE-së për zhvillimin e qëndrueshëm, të miratuar nga Këshilli Evropian në vitin 2006. Zhvillimi i qëndrueshëm është qëllimi përfundimtar i bashkëpunimit evropian në Bashkimin Evropian.

III. KORNIZA JURIDIKE PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT

Korrupsioni është një nga kërcënimet më të mëdha për sigurinë dhe stabilitetin e një vendi sepse nxit të gjitha format e krimit. Korrupsioni ngadalëson zhvillimin ekonomik, krijon pasiguri në mjedisin afarist të një vendi, pengon proceset e zbatimit të legjislacionit pozitiv dhe harmonizimin me parimet e sundimit të ligjit ekzistues të BE-së. Rezultati përfundimtar i korrupsionit të pakontrolluar në një shoqëri gjithmonë është mosbesimi i qytetarëve ndaj qeverive, institucioneve publike dhe vetë demokracisë si një formë e rendit shoqëror⁸.

Kostoja e vërtetë e korrupsionit nuk mund të matet me shumën e rryshfetit të paguar ose keqpërdorimin e parave publike. Ai poashtu shkakton humbje të produktivitetit për shkak të shterrjes së burimeve. Në rastet më të rënda, kontribuon në delegjitimin e shtetit, duke çuar në jostabilitet ekonomik dhe politik.

Një nga sfidat kryesore për vendet e Ballkanit Perëndimor është korrupsioni. Ballafaqimi me korrupsionin është një parakusht për progresin dhe demokratizimin e mëtejshëm të këtyre shteteve, dhe anëtarësimin e plotë në BE⁹.

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparencës Ndërkombëtare për vitin 2020, Republika e Maqedonisë së Veriut shënon renditjen më të ulët që nga viti 2001.¹⁰

III.1. Korniza nacionale juridike për luftë kundër korrupsionit

Kornizën nacionale juridike për luftë kundër korrupsionit e përbëjnë këto ligje kyçe:

- **Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave** (Gazeta Zyrtare e RM, nr.128/09, nga data 22.10.2009). Me këtë ligj parashihen masat dhe aktivitetet për parandalimin e korrupsionit në ushtrimin e qeverisjes, kompetencave publike, detyrave zyrtare dhe politikëbërjes, si dhe masat dhe aktivitetet për parandalimin e konfliktit të interesit, masat dhe aktivitetet për parandalimin e korrupsionit në kryerjen e veprimtarive dhe ushtrimin e kompetencave publike me interes publik nga persona juridikë.
- **Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve** (Gazeta Zyrtare e RM, nr.196/2015, 35/18). Ky ligj trajton sinjalizimin e mbrojtur në sektorin publik dhe privat, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, të drejtat e sinjalizuesve, si dhe veprimet dhe përgjegjësitë e institucioneve, përkatësisht personave juridikë lidhur me sinjalizimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së sinjalizuesve.

8 https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/file_import/european-semester_thematic-factsheet_fight-against-corruption_en_0.pdf <http://www.aalep.eu/fighting-corruption-eu-long-way-go>

9 <http://antikorrupcija.mk/uploads/records/file/Po.licy%20brief%20MCMCS,%20October%202019.pdf>

10 http://www.transparency.mk/images/stories/2021/prezentacija_cpi2020.pdf

- **Ligji për lobim** (Gazeta Zyrtare, nr.106 nga data 27.08.2008) i referohet lobimit te autoritetet legjislativ dhe ekzekutive në nivel qendror dhe lokal, si dhe rregullon parimet e lobimit, kushtet për marrjen e statusit të lobistit, regjistrimin e lobistëve, mbajtjen e Regjistrimit të lobistëve, të drejtat dhe përgjegjësitë e lobistëve, aktivitetet që nuk konsiderohen lobim, mbikëqyrjen e lobimit dhe masat që mund t'i shqiptohen lobistit për mosrespektim të dispozitave të këtij ligji.
- **Ligji për financimin e partive politike** (Gazeta Zyrtare e RM, nr.76/2004, 86/2008, 161/2008, 96/2009, 148/11, 142/12 dhe 23/2013). Ky ligj rregullon mënyrën dhe procedurën e sigurimit të mjeteve financiare, disponueshmërinë e mjeteve financiare për funksionimin dhe veprimtaritë aktuale të partisë politike, si dhe mënyrën e kontrollit të financimit dhe funksionimit financiar-material të partive politike.
- **Ligji për qasje të lirë në informacionet me karakter publik** ("Gazeta Zyrtare e RMV", nr.101/2019) siguron bazën për ushtrimin e së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik, me të cilat disponojnë autoritetet shtetërore, organet dhe organizatat tjera të përcaktuara me ligj, organet komunale, Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, institucionet dhe shërbimet publike, ndërmarrjet publike, personat juridikë dhe fizikë që ushtrojnë kompetenca publike të përcaktuara me ligj dhe veprimtari me interes publik, si dhe partitë politike në kontekst të të hyrave dhe shpenzimeve.

Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave definojnë korrupsionin si keqpërdorim detyre, abuzim me autoritetin publik, detyrën zyrtare ose pozicionin, me qëllim për të përfutur personalisht ose për një person tjetër, drejtpërdrejt ose përmes një ndërmjetësi.

Termi korrupsion, në kontekst të këtij ligji, përfshin edhe nocionet për:

- korrupsion pasiv, që definohet si veprim i qëllimshëm i një zyrtari i cili, drejtpërdrejt ose përmes një ndërmjetësi, kërkon ose merr përfitime të çdo lloji, për vete ose për një palë të tretë; dhe
- korrupsion aktiv – veprim i qëllimshëm i çdo personi i cili, drejtpërdrejt ose përmes një ndërmjetësi, jep çdo lloj premtimi ose ofron përfitim një zyrtari, për të ose për një palë të tretë, në mënyrë që të veprojë ose të përmbahet nga veprimi në përputhje ose në kundërshtim me detyrimet dhe përgjegjësitë zyrtare të tij/saj.

Ky ligj konfliktin e interesit e definojnë si një situatë në të cilën zyrtari ka një interes privat që ndikon ose mund të ndikojë në kryerjen objektive të kompetencave publike ose detyrave të tij/saj zyrtare.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është një organ i specializuar i pavarur, i themeluar në vitin 2002, ndërsa kompetencat aktuale iu përcaktuan me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, të miratuar në janar të vitit 2019. Ato kanë të bëjnë me procesin e politikëbërjes, monitorimin dhe mbikëqyrjen, si dhe me bashkëpunimin me organet tjera shtetërore, me qëllim parandalimin e korrupsionit. KSHPK është përgjegjës për zbatimin e masave dhe aktiviteteve për

parandalimin e korrupsionit në ushtrimin e pushtetit, kompetencave publike, detyrës zyrtare dhe politikëbërjes, si dhe për masat dhe aktivitetet për parandalimin e konfliktit të interesit, masat dhe aktivitetet për parandalimin e korrupsionit në kryerjen e veprimtarive me interes publik të personave juridikë që kanë të bëjnë me ushtrimin e kompetencave publike. Ligji për parandalimin e korrupsionit rriti kompetencat e KSHPK-së dhe siguroi mekanizma më efektivë për veprim, gjë që rriti edhe pritjet e opinionit publik për një veprim më efikas në drejtim të parandalimit të korrupsionit në shoqërinë tonë.

Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit është përgjegjëse për format më komplekse të krimit të organizuar dhe korrupsionit të lartë, e poashtu për trajtimin e lëndëve që lidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Selia e Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit është në Shkup. Kjo prokurori përgjigjet para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili mbikëqyr punën e saj, si dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë. Garanci kryesore për funksionimin e kësaj prokurorie në përputhje me ligjet është pavarësia financiare, që paraqet shtyllën themelore dhe parakushtin për pavarësinë e secilit institucion, përfshirë Prokurorinë Publike.

III.2. Dokumente strategjike në luftën kundër korrupsionit

Gjatë vitit 2019, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), konform kompetencave ligjore, përmes një procesi të gjerë pjesëmarrës dhe konsultimit me të gjitha palët e interesit, hartoi Strategjinë e re Nacionale për luftimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit për periudhën 2021-2025. Strategjia ka vendosur si objektiva kryesore këto pika:

- Rritjen e nivelit të përgjegjësisë politike dhe vullnetit të demonstruar për luftë kundër korrupsionit;
- Qeverisjen e ndërgjegjshme me ndikim politik në sektorin publik dhe parandalimin e ndikimit politik në punën e organeve të pavarura dhe procedurave të parapara me ligj;
- Forcimin e integritetit dhe llogaridhënies në sektorin publik;
- Ushtrimin e kompetencave në sektorin publik në mënyrë ligjore, transparente, etike, ekonomike, të përgjegjshme dhe efektive;
- Sigurimin e integritetit dhe transparencës në procedurat e punësimit dhe politikave të burimeve njerëzore në sektorin publik, bazuar në sistem vlerash dhe kritereve për cilësi;
- Forcimin e mekanizmave mbikëqyrës dhe kontrollues;
- Digjitalizimin e shërbimeve publike;
- Zvogëlimin e korrupsionit në prokurimet publike dhe në procesin e dhënies së granteve, subvencioneve dhe ndihmave tjera shtetërore;
- Forcimin e kapaciteteve dhe përkushtimit të organeve të zbatimit të ligjit, të prokurorisë dhe gjyqësisë në zbulimin dhe sanksionimin e korrupsionit, si dhe fuqizimin e rezistencës ndaj korrupsionit në radhët e tyre;

- Mbështetjen e parimit të transparencës dhe integritetit në sektorin privat;
- Vetëdijësimin publik dhe realizimin e edukimit antikorrupsion; dhe
- Përfshirjen e shoqërisë qytetare dhe mediave në luftën kundër korrupsionit dhe ndërtimin e integritetit personal dhe profesional.

Strategjia identifikon dhe zgjedh çështjet prioritare që gjenerojnë një rrezik të lartë të korrupsionit dhe identifikon masat për t'i kapërcyer ato.

Në tekstin e mëtejshëm të analizës, do të shqyrtohen problemet në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, që janë detektuar në Strategjinë Nacionale dhe në dokumentet tjera të KSHPK, si dhe masat për trajtimin e tyre.

III.3. Korniza ndërkombëtare juridike për luftë kundër korrupsionit

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit (UNCAC)

Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 2003 ratifikoi Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) kjo Konventë është instrumenti i parë i detyrueshëm ligjor antikorrupsion. Në shumë prej dispozitave të saj, kjo konventë ka fushëveprim dhe mandat të gjerë dhe kjo e bën atë një mjet të jashtëzakonshëm për zhvillimin e një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj korrupsionit si një problem global.

Ky dokument i rëndësishëm ndërkombëtar – i cili synon të promovojë dhe forcojë masat për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në mënyrën më efektive, të promovojë, lehtësojë dhe mbështesë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe asistencën teknike për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, duke përfshirë rikthimin e pronës dhe avancimin e integritetit, llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë të çështjeve publike dhe pronës shtetërore – parashikon që secili shtet nënshkruer i Konventës të përgatisë, zbatojë ose ndjekë politikat efektive antikorrupsion dhe koordinatat që favorizojnë pjesëmarrjen e shoqërisë dhe shprehin parimet e shtetit të së drejtës, qeverisjen e mirë të çështjeve publike dhe pronës së shtetit, integritetin, transparencën dhe llogaridhënien, në përputhje me parimet themelore të sistemit ligjor të vendit. Çdo shtet nënshkruer i Konventës do të përpiqet të zbatojë dhe avancojë praktika efektive për parandalimin e korrupsionit.¹¹

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në një numër të dokumenteve përcakton pozicionin e saj në luftën kundër korrupsionit, bazuar kryesisht në Konventën e UNCAC. Vendimi nr.5/14¹² për Parandalimin e Korrupsionit nga viti 2014 në Bazel, inkurajon shtetet-pjesëmarrëse të zhvillojnë dhe zbatojnë legjislacionin dhe politikat antikorrupsion, dhe të vendosin dhe promovojnë masa dhe vegla praktike për

11 <https://customs.gov.mk/images/documents/borbaKorupcija/oonProtivKorupcija.pdf>

12 <https://www.osce.org/files/f/documents/b/b/130411.pdf>

t'u ballafaquar me të gjitha format e korrupsionit, si dhe për të ndërmarrë masa për rritje të transparencës, përgjegjësisë dhe sundimit të ligjit në administratën publike, përfshirë edhe lehtësimin e qasjes së opinionit publik në informacione dhe avancimin e shërbimeve publike efikase. Nga ana tjetër, vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së 6/20 nga dhjetori 2020, në Tiranë¹³, u bën thirrje shteteve-pjesëmarrëse të parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin duke përmirësuar qeverisjen e mirë, përfshirë parimet e transparencës dhe llogaridhënies, dhe duke promovuar mjete digjitale të administratës publike për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe zbulimin e tij të hershëm. Ky vendim i rëndësishëm i OSBE-së, ndër të tjera, parashikon krijimin e kanaleve lehtësisht të qasshme dhe të sigurt për "sinjalizuesit", vendosjen e mekanizmave ligjorë për mbrojtje efektive të "sinjalizuesve" kundër hakmarrjes dhe inkurajimin e organizatave përkatëse në vendosjen e mbrojtjes së nevojshme, në pajtim me ligjin e brendshëm.¹⁴

Reformat antikorrupsion janë ndër kërkesat kryesore për pranimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE. Politika e kushtëzimit që zbaton BE ndaj vendeve kandidatë paraqet nxitjen kryesore të reformave dhe përpjekjeve në luftën kundër korrupsionit.

Kjo politikë fillon nga logjika se vendet e Ballkanit Perëndimor të cilat duan të bëhen anëtare të plota të BE-së, duhet të plotësojnë disa kritere dhe kushte. Kushtëzimi i BE-së përfshin transpozimin e legjislacionit të saj në ligjin e brendshëm, ristrukturimin e institucioneve vendase në përputhje me rregullat e BE. Sundimi i ligjit është një nga vlerat themelore të BE-së dhe vendet që duan t'i bashkangjiten Bashkimit Evropian duhet që në fazë të hershme të krijojnë dhe të promovojnë funksionimin e duhur të institucioneve kryesore, ndërsa arritja e rezultateve të dukshme në këtë drejtim është një element i rëndësishëm për të kaluar në fazën tjetër të procesit të anëtarësimit në BE. Sundimi i ligjit, përfshi luftën kundër korrupsionit, është fusha më e vështirë për harmonizim, duke pasur parasysh që me kalimin e kohës kushtet e BE-së janë bërë më të rrepta dhe më të ndërlikuara.¹⁵

Konventa e së Drejtës Penale për Korrupsion¹⁶ është një instrument i cili synon që vendet nënshkruese të ndërmarrin veprime të koordinuara për të kriminalizuar një numër të madh të praktikave kriminale. Ajo siguron masa komplementare të ligjit penal dhe rrit bashkëpunimin e shteteve nënshkruese të saj në fushën e veprave penale të lidhura me korrupsion. Zbatimi i kësaj Konvente monitorohet nga GRECO – një grup shtetesh nënshkruese të Konventës, e cila hyri në fuqi më 1 maj 1999. Kjo Konventë është paraparë si një mjet për të përmirësuar kapacitetin e shteteve nënshkruese në luftën kundër korrupsionit, përmes mbikëqyrjes që ndjek dhe siguron zbatimin e standardeve

13 <https://www.osce.org/files/f/documents/3/7/479759.pdf>

14 <https://www.osce.org/files/f/documents/2/b/472833.pdf>

15 <http://www.antikorupcija.mk/uploads/records/file/Policy%20brief%20MCMS,%20October%202019.pdf>

16 <https://rm.coe.int/168007f3f5>

antikorrupsion të Këshillit të Evropës me një proces vlerësimi, gjetjet e të cilit janë botuar në raporte të ndryshme. GRECO përbëhet nga 48 vende evropiane, përfshi edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kazakistanin.

Raporti i fundit i GRECO-s, i botuar në shtator të vitit 2020, konstaton se Maqedonia e Veriut ka zbatuar ose është ballafaquar në mënyrë të kënaqshme me nëntëmbëdhjetë rekomandimet e përfshira në Raportin e Raundit të Katërt të Vlerësimit. Nga rekomandimet e mbetura, tetë janë zbatuar pjesërisht dhe dy nuk janë zbatuar fare¹⁷.

Fenomeni i shtetit të kapur

Termi shteti i kapur i referohet proceseve në të cilat institucionet shtetërore dhe palët ndërmjetësuese siç janë partitë politike ose parlamentet, rrëmbehen nga ose në to infiltrohen rrjete klienteliste, dhe ato u japin një mantel formal praktikave të tyre joformale të vendimmarrjes, përfshi këtu edhe praktikën e korrupsionit.

Kur bëhet fjalë për korrupsionin në vend, seriozitetin e situatës e konstatojnë studime të shumta të kohëve të fundit. Korrupsioni edhe më tutje mbetet një problem serioz dhe ekziston pandëshkueshmëri e përhapur për zyrtarët e korruptuar qeveritarë, përfshi anëtarët e Kuvendit dhe gjyqësorin, konstaton Raporti i Freedom House për Maqedoninë e Veriut, për vitin 2020.¹⁸

Fenomeni i shtetit të kapur u analizua në një studim rajonal të Transparency International, raporti i të cilit u botua në dhjetor të vitit 2020. Gjetjet e këtij studimi tregojnë se janë dy elementë kryesorë që mundësojnë një shtet të kapur në Ballkanin Perëndimor: **mosndëshkimi i korrupsionit të nivelit të lartë dhe ligjet e përshtatura sipas nevojës apo interes të një subjekti apo individi**. Analiza e shembujve specifik nga vendet e këtij rajoni, përfshi Maqedoninë e Veriut, jep pasqyrë të trajtimit joefikas që gjyqësori i bën korrupsionit të zyrtarëve të lartë të shtetit, e gjithashtu tregon se si ky problem, së bashku me ndikimin e paligjshëm në miratimin e ligjeve për interesa private, ndihmojnë në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e një shteti të kapur në Ballkanin Perëndimor. Ligjet dhe institucionet kryesore që duhet t'i zbatojnë ato, janë të dobëta apo edhe mbështesin korrupsionin dhe shtetin e kapur. Dobësitë në ndjekjen penale të korrupsionit fuqizojnë atë, ndërsa ndikimi i paligjshëm i miratimit të ligjeve mund ta legalizojë korrupsionin dhe kapjen

17 <https://rm.coe.int/-85-21-25/16809fc810>

18 <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/freedom-world/2020>

e shtetit. **Ligjet mundësojnë kontrata të privileguara, ulje të gjobave dhe mundësojnë privatizimin e të mirave publike për të mirën e një grupi të caktuar të personave.**

“Receta” duket e njëjtë kudo – në fillim dobësohet gjyqësori, me çka pengohet ndjekja efektive e korrupsionit. Më pas lejohet që në Kuvend të miratohen ligje që legalizojnë shtetin e kapur. Bëhet gjithnjë e më vështirë që një zyrtar i korruptuar të përgjigjet për veprat e tij/saj dhe gjithnjë e më lehtë të monopolizohen industritë dhe resurset publike. Kjo mundëson që funksionarët e akuzuar për korrupsion t’i shmangen përgjegjesisë penale. Disa aspirojnë të zënë një pozitë të lartë në qeveri dhe të përfitojnë nga një sistem i tillë. Kjo përsëritet në sektorë të ndryshëm. Sipas një studimi të *Transparency International*, korrupsioni ka një efekt negativ në mjedisin jetësor, zonat urbane, sektorin afarist dhe aspekte tjera të jetës së përditshme¹⁹.

III.4. Transparenca si parim kryesor në luftën kundër korrupsionit në fushën e mjedisit jetësor

Mbrojtja e mjedisit jetësor nuk është vetëm një e drejtë themelore njerëzore dhe obligim i shtetit, por është edhe një sferë që prek të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë dhe në të cilën pasqyrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojat themelore të njeriut – nevoja për ajër të pastër, ujë të pastër, tokë të pandotur, të pastër dhe mjedis natyror të ruajtur. Një nga dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare që vendos parimet themelore në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor është **Konventa e Arhusit** dhe ajo është pjesë e legjisllacionit vendas të ratifikuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 1999.

Në preambulën e saj thuhet se mbrojtja adekuate e mjedisit jetësor është thelbësore për të mirën e njeriut dhe që ai të gëzojë të drejtat themelore, përfshi edhe të drejtën për jetë.²⁰ Gjithashtu theksohet se, për të qenë në gjendje të ushtrijnë këtë të drejtë dhe këtë detyrë, qytetarët duhet të kenë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të kenë qasje në drejtësi për çështje të mbrojtjes së mjedisit jetësor, dhe se me përmirësimin e qasjes në informata dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, zgjerohet cilësia dhe zbatimi i vendimeve, kontribuohet në ndërgjegjësimin e publikut për aspektet e mbrojtjes së mjedisit jetësor, opinionit publik i jepet mundësia për të shprehur shqetësimet e tij, ndërsa autoriteteve publike u jepet mundësia që shqetësimeve të tilla t’u kushtojnë vëmendjen e duhur.

Konventa e Arhusit vendos tre shtyllat më të rëndësishme për qytetarin kur bëhet fjalë për mjedisin jetësor:

19 https://images.transparencycdn.org/images/2020_Report_ExaminingStateCapture_English.pdf

20 <https://unece.org/DAM/env/pp/documents/cep43mac.pdf>

- Qasjen në informacione,
- Pjesëmarrjen e opinionit publik në vendimmarrje; dhe
- Qasjen në drejtësi për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor – duke bërë dallimin në mes publikut të përgjithshëm dhe publikut të prekur nga këto çështje.

Konventa e Arhusit është një përfitim i rëndësishëm sepse detyron autoritetet qendrore dhe lokale të jenë transparente dhe llogaridhënës, e rrjedhimisht edhe përgjegjës për punën e tyre, dhe për herë të parë ndërlihd të drejtat themelore të njeriut me të drejtat ekologjike.

Republika e Maqedonisë së Veriut gjithashtu ka ratifikuar Protokolin e Kievit mbi Regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (RSHTN)²¹, që erdhi si rezultat i përvojës së frikshme nga një tragjedi ekologjike pas shpërthimit të një fabrike kimike në qytetin indian të Bopalit që vrau disa mijëra dhe lëndoi gjysëm milionë banorë, dhe i cili protokol bazohet në parimin e thjeshtë: „**Ti ke të drejtë ta dish**”. Ky protokol gjithashtu miraton parimet kryesore si rekomandime për autoritetet e shteteve nënshkruese: e drejta për qasje në informacione, e drejta e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje për çështje të mjedisit jetësor dhe e drejta e qasjes në drejtësi lidhur me çështje të mjedisit jetësor.

Hapat për të përfshirë publikun në procesin e vendimmarrjes lidhur me aktivitete e rëndësishme që kanë të bëjnë me një mjedis jetësor të shëndetshëm, tregojnë se vendet e zhvilluara në kalimin nga shekulli XX në shekullin XXI i kanë kushtuar vëmendje të madhe vendosjes së rregullave të reja dhe më të ndryshme të sjelljes kur bëhet fjalë për të drejtën për një mjedis jetësor të pastër, të shëndetshëm dhe të sigurt. Qasja e re do të thotë në mënyrë të pashmangshme që publiku duhet të jetë në rrjedha për çdo veprimtari që mund të ketë ndikim të mundshëm negativ mbi mjedisin jetësor dhe të shprehë atë që mendon se duhet ose nuk duhet të bëhet, si dhe të kërkojë drejtësi për atë që konsideron se po e kërcënon atë ose mjedisin jetësor. Për shkak të kësaj më lartë, nuk është rastësi që ekziston një këmbëngulje për pjesëmarrjen e publikut kur bëhet fjalë për një sistem aq të rëndësishëm për njerëzit, siç është mbrojtja e mjedisit jetësor. Ky parim është i ngulitur edhe në themelet e “Kushtetutës ekologjike” të Republikës së Maqedonisë së Veriut, siç e quajnë Ligjin për mjedisin jetësor. Ai përcakton parimet e mëposhtme për qasje në informata për mjedisin jetësor:

- Çdokush ka të drejtë të ketë qasje në informacione për mjedisin jetësor, pa pasur nevojë ta shpjegojë interesin e vet;
- E drejta për qasje në informata realizohet në mënyrë të paraparë me ligj;
- Të gjithë organet e përcaktuara me ligj kanë obligim të sigurojnë informacione për mjedisin jetësor;
- Refuzimi i kërkesës të jepet informatë mund të bëhet vetëm në rrethana të caktuara;

21 <https://ripz.moepp.gov.mk/Content/About>

- Organet e përcaktuara me këtë ligj e kanë për detyrë të mbledhin dhe të publikojnë informacione për mjedisin jetësor nga fushëveprimi i kompetencave të tyre;
- Kompenzimi i shpenzimeve për dhënien e informacionit të kërkuar do të jetë i arsyeshëm dhe nuk do të tejkalojë shpenzimet reale; dhe
- Pala e pakënaqur ka të drejtë të ketë qasje në drejtësi.

Neni 17 i ligjit të njëjtë obligon pushtetin qendror dhe lokal t'i sigurojnë të gjitha masat e nevojshme dhe të përcaktojnë procedura që mundësojnë realizimin e së drejtës për qasje në informacione dhe pjesëmarrjen e publikut në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me gjendjen e mjedisit jetësor, si dhe të sigurojnë mendimin e publikut për procedurën e marrjes së vendimeve përkatëse. Parimi i pjesëmarrjes së publikut dhe qasjes në informata është një nga 14 parimet bazë për mbrojtjen e mjedisit jetësor, e ato janë:

- shkallë e lartë mbrojtjeje,
- integritet,
- zhvillim i qëndrueshëm,
- kujdes,
- parandalim,
- prodhim më të pastër,
- pagesa nga ndotësi dhe shfrytëzuesi,
- subsidiaritet,
- proporcionalitet,
- bashkëpunim ndërkombëtar,
- vetëdijësim publik; dhe
- klauzolë mbrojtëse.

Për të rregulluar më saktësisht pjesëmarrjen e publikut në marrjen e vendimeve në fushën e mjedisit jetësor, në vitin 2008 u miratua Dekreti për pjesëmarrjen e publikut²² gjatë përgatitjes së rregulloreve dhe akteve tjera, si dhe planeve dhe programeve në fushën e mjedisit jetësor. Ai përshkruan procedurat, kushtet dhe mënyrat për pjesëmarrjen e publikut gjatë përgatitjes së rregulloreve, planeve dhe programeve në fushën e mjedisit jetësor, llojet e planeve dhe programeve, mënyrën dhe procedurën për pjesëmarrjen e publikut në përgatitjen, miratimin, ndryshimin ose rishikimin e planeve dhe programet, si dhe mënyrën dhe kriteret në bazë të të cilave do të përcaktohet publiku, përfshi organizatat joqeveritare.

Në procedurën për hartimin e rregulloreve, akteve tjera dhe dokumenteve të planifikimit, organet e administratës shtetërore dhe komunat duhet t'i mundësojnë publikut që të marrë pjesë efektivisht në hartimin e rregulloreve dhe në miratimin, ndryshimin dhe rishikimin e dokumenteve të planifikimit në fazën më të hershme të miratimit të tyre, gjegjësisht gjatë marrjes së vendimeve. Organet duhet të informojnë publikun dhe

shoqatat qytetare, përkatësisht publikun e interesuar, përmes njoftimeve publike të botuara në të paktën një gazetë ditore që distribuohet në gjithë territorin e vendit dhe ueb-sajtin e organit përkatës, ose përmes njoftimeve publike në mediat elektronike lidhur me vendimet e miratuara ose planet dhe programet e zhvilluara, si dhe të ofrojnë mundësinë për të kontaktuar dhe dërguar vërejtjet, sugjerimet dhe mendimet, përfshi edhe afatin e fundit për dorëzimin e tyre. Është veçanërisht e rëndësishme që organi kompetent të sigurojë pjesëmarrjen e publikut të interesuar në të paktën një seancë dëgjimore publike dhe të vendosë draft-rregulloren dhe draft-dokumentin e planifikimit për inspektim publik në ueb-faqen e tij, me ç'rast inspektimi publik duhet të zgjasë të paktën 30 ditë, ndërsa seanca dëgjimore publike duhet të mbahet të paktën 15 ditë pasi që ky dokument të jetë bërë publik. Për zhvillimin e seancës dëgjimore organi përkatës mban procesverbale, si dhe një listë të të gjithë pjesëmarrësve në diskutim. Në afat prej 30 ditësh organi përkatës duhet të paraqesë një përgjigje individuale ose kolektive për të gjitha vërejtjet e pranuar, të përgatit një raport mbi seancën dëgjimore publike dhe ta publikojë atë në ueb-faqen e tij.

Me këtë qartë potencohet se gjërat që ndikojnë në mjedisin jetësor nuk mund dhe nuk duhet të ndodhin dhe të zgjidhen larg vëmendjes së publikut, pa e informuar atë në kohë dhe në mënyrën e duhur, si dhe pa e pyetur se çfarë mendon për projektet, planet dhe vendimet që në emër të tij i miratojnë institucionet shtetërore dhe lokale.

Publiku dhe llogaridhënia në dokumentet për luftë kundër korrupsionit

Roli dhe domethënia e parimit të pjesëmarrjes së publikut, transparenca në punën e administratës publike, e rrjedhimisht edhe përgjegjësia në luftën kundër korrupsionit, janë disa nga parimet kryesore të përfshira në Konventën e OKB-së kundër korrupsionit. Në nenin 10 të Konventës UNCAC thuhet: “Duke marrë parasysh domosdoshmërinë e luftës kundër korrupsionit, çdo shtet nënshkrues, në përputhje me parimet themelore të ligjit vendor, do të ndër marrë masat e nevojshme për të rritur transparencën e administratës publike të tij, si dhe organizimin, funksionimin dhe proceset e vendimmarrjes”. Prandaj, shtetet nënshkruese duhet të hartojnë dhe miratojnë procedura që do t’u sigurojnë qytetarëve qasje në informacione lidhur me organizimin dhe procedurat e vendimmarrjes së administratës publike, të thjeshtësojnë procedurat administrative për një qasje më të lehtë në organet kompetente vendimmarrëse dhe të sigurojnë publikimin e informacioneve, e mundësisht edhe të raporteve periodike mbi rreziqet e korrupsionit në fushën e administratës publike.

Në po këtë Konventë më tej theksohet se, në parandalimin e korrupsionit dhe në luftën kundër kësaj dukurie (neni 13), çdo shtet ka për obligim që publikut t’i mundësojë mbikëqyrje në punën e sektorit publik, duke rritur transparencën e procedurave të vendimmarrjes dhe avancimin e pjesëmarrjes së publikut në këto procese, si dhe duke siguruar qasje efektive të publikut në këto informacione.

Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit gjithashtu parashikon parimin e publicitetit si një nga parimet themelore që vendos shoqëria kur bëhet fjalë për luftën kundër korrupsionit. Sipas nenit 6, ushtrimi i pushtetit, funksionit, kompetencave publike, detyrës zyrtare dhe çështjeve me interes publik – janë publike dhe i nënshtrohen kontrollit publik. Askush nuk mund të thirret në zbatimin e një ligji ose rregulloreje tjetër që do të kufizonte ose përjashtonte publikun, në mënyrë që të fshehë korrupsionin ose konfliktin e interesit. Në këtë drejtim, ky ligj parashikon mbrojtjen e mediave që publikojnë raste korrupsioni. Neni 68 ndalon çdo presion, parandalim ose ndikim tjetër ndaj mjeteve të informimit publik për të publikuar ose mospublikuar informacione për raste korrupsioni dhe konflikte interesi. Sipas ligjit, gazetarit i njihet e drejta për qasje të papenguar në të gjitha burimet e informacionit. Poashtu në këtë nen theksohet se askush nuk mund ta përjashtojë publikun nga debati për korrupsion dhe konflikt interesi përpara një organi kompetent ose personi juridik, përveç se kur bëhet fjalë për një procedurë paraprake që është shpallur konfidenciale. Askush nuk mund të kërkojë nga gazetari që ka publikuar informacion mbi një akt korrupsioni dhe konflikt interesi, të zbulojë burimin e informacionit.

Mund të konkludohet se parimi i publicitetit paraqet thelbin e së drejtës së një mjedisi të shëndetshëm dhe detyrimit për ta mbrojtur atë, por edhe një kusht të domosdoshëm për luftë kundër korrupsionit. Respektimi i së drejtës së publikut dhe konsiderata e interesit publik në thelb ka të bëjë me korrupsionin, sepse respektimi i parimit të publicitetit dhe interesit publik është diametralisht i kundërt me fenomenet korruptive ose potencialisht korruptive në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Mjedisi jetësor në dokumentet e KSHPK për luftë kundër korrupsionit

Në Strategjinë Nacionale për luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit 2021–2025, si një problem prioritar në sektorin e mjedisit jetësor u detektua zbatimi jokonsistent i Ligjit për menaxhimin e mbeturinave, në pjesën e menaxhimit të integruar dhe rajonal të mbeturinave. Miratimi i këtij dokumenti u parapri nga një draft-verzion i tekstit të Strategjisë Nacionale për luftimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit për periudhën 2020–2024, i cili, përveç problemit me moskrijimin e sistemit të integruar për menaxhimin rajonal të mbeturinave, gjithashtu theksoi problemin me zbatimin e kompetencave të vetëqeverisjes lokale për mbrojtjen e mjedisit jetësor si prioritete që duhet trajtuar gjatë periudhës pesëvjeçare.

Gjatë përgatitjes së Strategjisë Nacionale, KSHPK përgatiti një Vlerësim të rreziqeve për korrupsion, lidhur me nevojat e planifikimit strategjik të luftës kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit në Republikën e Maqedonisë së Veriut²³, i cili analizoi rreziqet e korrupsionit në tetë fusha kryesore, përfshirë mjedisin jetësor për pesë procese horizontale:

23 https://dksk.mk/fileadmin/user_upload/2019/Procenka_na_rizicite_od_korupci_a_02.10.2019_mk.pdf

- prokurimet publike,
- punësimet në sektorin publik,
- mbikëqyrjen inspektoriale,
- dhënien e pëlqimeve, vendimeve, licencave dhe lejeve të ndryshme; dhe
- dhënien e granteve, subvencioneve.

Nga analiza e bërë nga ky dokument konkludohet se në sektorin e mbrojtjes së mjedisit jetësor, rreziku për korrupsion vlerësohet si shumë i mundshëm. Rrjedhimisht, paraqiten këto sfida që burojnë nga korniza ligjore dhe institucionale e procedurave për dhënien e lejeve ekologjike dhe dokumenteve tjera:

- Korniza e gjerë dhe laramane juridike, e cila përfshin shumë nënsektorë nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe karakterizohet me nivele të ndryshme të harmonizimit me legjislacionin evropian, që krijon mundësinë për “shtyerjen” e zbatimit të standardeve të caktuara ekologjike;
- Vonesa në zbatimin e rregullores ligjore nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor;
- Praktika e mosndëshkueshmërisë së sjelljes korruptive lidhur me (mos)zbatimin e rregullores ligjore.

Në vijim janë sfidat që burojnë nga faktori njeri dhe nga procedurat operative për dhënien e lejeve dhe dokumenteve tjera:

- Qasja subjektive dhe interpretimi i ndryshëm i kushteve dhe dokumenteve të nevojshme për dhënien e një vendimi të caktuar etj., nga ana e zyrtarëve të ndryshëm kompetentë në institucionet përkatëse;
- “Shtyerja” e zbatimit të masave të caktura ekologjike për entitete “të përzgjedhura” afariste.

Në vijim janë sfidat që burojnë nga ndikime tjera të jashtme mbi procedurat e dhënies së vendimeve, lejeve, marrëveshjeve për koncesione dhe dokumenteve tjera:

- Probleme me sundimin e ligjit, që rezultojn me shkallë të ulët sanksionimi për sjellje korruptive në nivel të gjithë shoqërisë;
- Ndikimi politik dhe presionet nga sektori privat për shtyerjen e zbatimit të obligimit ligjor për posedimin e lejeve ekologjike dhe dokumenteve tjera nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor;

Analiza e rrezikut në sektorin e mjedisit jetësor përmbledhet në gjetjen e mëposhtme: “Në dhënien e lejeve ekologjike dhe dokumenteve tjera në sektorin e mbrojtjes së mjedisit jetësor, ekziston rrezik korrupsioni për shkak të pasaktësive në legjislacion dhe vonesave në zbatimin e ligjeve. Prandaj, integriteti i burimeve njerëzore në institucionet publike për zbatimin e legjislacionit, së bashku me praktikën e (pa)ndëshkueshmërisë në shoqëri, luan një rol vendimtar nëse korrupsioni do të ndodhë apo jo”.

Për mosndëshkueshmërinë e krimit në mjedisin jetësor

Sipas informacioneve nga Prokuroria Publike e RMV²⁴, për krime kundër mjedisit jetësor dhe natyrës nga Kapitulli 22 i Kodit Penal gjatë vitit 2019, Prokuroria Publike ka proceduar kallzime penale ndaj gjithsej 421 personave, nga të cilët 271 persona ishin përfshirë në veprime jologjore rishitas dhe 150 në një periudhë më të hershme.

Në vitin 2019 prokuroritë publike ngritën padi kundër gjithsej 141 personave, ndërkaq gjykatat shqiptuan dënime për 112 persona. Për krahasim, një vit më parë (2018), për veprat e njëjta penale u proceduan penalisht gjithsej 360 persona, u ngritën padi kundër 77 personave dhe u shqiptuan dënime ndaj 85 personave. Kjo tregon se në vitin 2019 ka një rritje të numrit të personave të raportuar, si dhe rritje të akuzave të ngritura dhe të dënimeve të shqiptuara për këto vepra penale.²⁵

Mirëpo, sa i përket korrupsionit në mjedisin jetësor, gjërat qëndrojnë ndryshe. Rasti i fundit i një padie të ngritur për aktivitete korruptive ishte në vitin 2015, i cili kishte të bëjë me ngjarje të vitit 2009 lidhur me marrjen e licencave për ruajtjen, trajtimin dhe/ose përpunimin e mbeturinave dhe një licencë për operator deponie, edhe pse nuk kishte plotësuar kushtet e nevojshme. Sipas informacioneve që janë në dispozicion, ky rast akoma nuk ka epilog përfundimtar gjyqësor.²⁶

Për praktikën e mosndëshkimit për sjellje korruptive në mjedisin jetësor, në lidhje me (mos)zbatimin e legjislacionit, gjithashtu flet edhe dokumenti i sipërpërmendur i KSHPK, Vlerësim i rreziqeve për korrupsion.

Një sistem gjyqësor joefikas paraqet faktor kryesor për përhapjen e korrupsionit. Për 80% të qytetarëve, që paraqet një rritje prej katër përqind krahasuar me vitin 2018, joefikasiteti i sistemit gjyqësor në luftën kundër korrupsionit dhe dëshira për pasurim të shpejtë personal (një rritje për gjashtë përqind krahasuar me vitin 2018), si dhe mungesa e kontrollit të rreptë administrativ të korrupsionit (gjithashtu e rritur për gjashtë përqind nga viti paraprak), janë tre faktorët kryesorë për përhapjen aq të madhe të korrupsionit. Për më tepër, për rreth 75% të qytetarëve, dyfishimi i detyrave zyrtare dhe interesat personale, si dhe kriza morale që ekziston në shoqëri, janë poashtu faktorë që ndikojnë në përhapjen e madhe të korrupsionit.

24 <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/izveshtaj-na-javnite-obvinitelstva-na-rsm-za-2019-godina.pdf>

25 <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/izveshtaj-na-javnite-obvinitelstva-na-rsm-za-2019-godina.pdf>

26 <https://jorm.gov.mk/osnovnoto-javno-obvinitelstvo-skopj-16/>

Po i njëjti raport konkludon se korrupsioni mbetet i pandëshkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nëse marrim parasysh se 29.4% e të anketuarve konfirmuan se ishin të përfshirë në korrupsion, dhe kjo përqindje projektohet te popullata e moshës madhore, mund të konkludohet se janë kryer rreth katërqind mijë vepra penale në fushën e korrupsionit. Nga ana tjetër, në vitin 2018 vetëm 95 persona (në 2017 ishin 119) janë dënuar për keqpërdorim detyre ose pranim ryshfeti, që nga rastet e zbuluara dhe me vendim gjyqësor paraqet efikasitet institucional prej 0,024%.

IV. ANALIZA E FUSHAVE TË MJEDISIT JETËSOR QË PREKEN LEHTË NGA KORRUPSIONI

Intervistat e kryera dhe inspektimet në terren, analiza e mbulimit mediatic, reagimet e qytetarëve në rrjetet sociale, sugjerimet e përfaqësuesve të organizatave të shoqatave qytetare për mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në hulumtime mbi situatën në disa fusha të ndryshme tematike lidhur me ekologjinë, energjetikën dhe ekonominë e qëndrueshme, çon në përfundimin se mospërputhja midis bazës ligjore dhe praktikës së funksionimit të sistemit të mbrojtjes së mjedisit jetësor, reflektohet negativisht në shumë sfera të mjedisit jetësor. Rastet e dokumentuara nga mediat ose nga shoqatat qytetare me prova për rrezikim të burimeve natyrore, biodiversitetin ose që rrezikojnë të drejtën e njeriut për ajër të pastër, ujë të pastër, tokë dhe ushqim të shëndetshëm janë rezultat i praktikës së zbatimit selektiv, jotransparent të dispozitave ligjore, që anashkalohen ose zbatohen në mënyrë jo konsistente.

Nga fundi i vitit 2020, ndryshimet në pozicionin drejtues të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Jetësor, një nga institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e ligjeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës, si dhe intensifikimi i inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të kryera nga Inspektorati, kontribuan për një rritje të rasteve të rishikimit të procedurave dhe lejeve për ndotësit ose për subjektet që kryejnë veprimtari në lidhje me mjedisin jetësor, e të cilat më parë ishin “të paprekshëm” për inspektorët, si dhe treguan se qasja e angazhuar dhe profesionale në mbrojtjen e interesit publik jep rezultate.

Analiza jonë nxori në pah katër fusha të mjedisit jetësor që janë veçanërisht të ekspozuara ndaj ndikimeve të vendimeve dhe procedurave të institucioneve kompetente dhe të cilat mënyrat e zbatimit të dokumenteve aktuale ligjore dhe strategjike, kanë provokuar reagime ose kanë nxitur polemika nga publiku (sidomos publiku i prekur) dhe shoqatat qytetare. Këto katër fusha që dallojnë janë:

1. Cilësia e ajrit dhe ndotja e ajrit,
2. Shfrytëzimi i burimeve të ujit dhe e drejta e ujit,
3. Menaxhimi i pyjeve,
4. Zonat e mbrojtura dhe rajonet që duhet të mbrohen.

Poashtu, analiza detektoi tre procese që prekin të gjitha katër fushat e mjedisit jetësor, e të cilat më lehtë i nënshtrohen korrupsionit:

1. Dhënia e lejeve për shfrytëzim, respektivisht për eksploitim,
2. Kontrolli inspektorial; dhe
3. Përfshirja e publikut.

IV.1. Cilësia e ajrit

Në fund të vitit 2019, Qeveria miratoi një Plan për ajër të pastër, i cili u cilësua si një program strategjik i Qeverisë dhe një nga prioritetet e saj, por ai zbatohet vetëm pjesërisht. Në programin e ri mbi ndotjen e ajrit janë zbatuar ose përfshirë rreth 30% të masave afatshkurtëra, ndërsa nga masat afatmesme dhe afatgjata janë pak më pak se 31%, që domethënë nga masat e përgjithshme të planifikuara, janë planifikuar të implementohen ose tashmë janë duke u implementuar vetëm 30.81%.²⁷ Qytetet me normat më të larta të ndotjes mesatare të ajrit janë Shkupi, Tetova, Kërçova dhe Manastiri.²⁸

Sferat me mundësi të madhe për ekzistimin e fenomeneve korruptive janë si më poshtë:

- **Dhënia e lejeve ekologjike** duke mos i kushtuar rëndësi nëse gjatë dhënies së lejes së integruar të kategorisë A ose B, organi kompetent respekton parimin e zbatimit të teknologjive dhe procedurave më të mira në dispozicion në mënyrë që subjektet mos të ndotin.²⁹
- **Mbikëqyrja inspektoriale** që kryhet në mënyrë të parregullt, jo të plotë, nuk përcakton shkaqet reale të ndotjes ose nuk kryhet fare; inspektimi i mjedisit jetësor nuk është në harmoni të plotë me ligjet e BE-së; inspektimi i planit të mjedisit jetësor kryhet në nivelin lokal dhe qendror pa koordinim; mungesa e një sistemi të vetëm të inspektimit të mjedisit jetësor, struktura joadekuate për koordinimin dhe mbikëqyrjen e inspektimit në nivelin lokal dhe qendror; mungesa e një plani qendror dhe programeve vjetore, nuk sigurojnë kontroll efektiv të inspektimit. Është hartuar një ligj i ri për inspektimin e mjedisit jetësor, por ende është në proces miratimi.³⁰
- **Laboratori i paakredituar shtetëror** pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor për metodat e ndotjes së ajrit. Nuk ka mirëmbajtje të rregullt, nuk ka blerje të pjesëve rezervë për stacione matëse, nuk janë dislokuar dy stacione ekzistuese të matjes për cilësinë e ajrit, nuk ka blerje të pajisjeve laboratorike dhe reagensëve kimikë, e as akreditim të laboratorit të kalibrimit dhe trajnim për punonjësit. Financimi jo i plotë për këtë program vë në pikëpyetje funksionimin e këtij sistemi³¹. Njoftimet e fundit nga Ministria³² tregojnë se, përveç akreditimit ISO për gjithë laboratorin, nuk ka mjete financiare për akreditimin e metodave individuale për matjen e grimcave ndotëse në ajër.
- **Tolerimi i zonave gri të trajtimit jolegal të mbeturinave**, të ashtuquajtura deponi ilegale dhe veprimet që ndodhin aty, siç janë hedhja dhe trajtimi i paligjshëm i

27 EkoSvest: Analiza e masave të rekomanduara për справување// me ndotjen e ajrit ambiental në Maqedoninë e Veriut, 2019, Analiza_Aero.pdf (ekosvest.com.mk)

28 programa_namaluvanje_aerzagaduvanje_mkd.pdf (vlada.mk)

29 <https://florozon.org.mk/downloads/investigative-stories/02/Integrirano-sprecurvanje-i-kontro-la-na-gragjanskoto-ucestvo.pdf>

30 (Joint_report_on_air_quality_2019-MQ_updated2.pdf (eurosaiwgea.org) faqe 78

31 (Joint_report_on_air_quality_2019-MQ_updated2.pdf (eurosaiwgea.org) faqe 79

32 <https://www.slobodenpecat.mk/drzhavnite-inspektori-se-potpiraat-na-merena-na-privatni-laboratorii/>

mbeturinave, djegia për fitimin e lëndës së parë, ndërtimi i lagjeve të egra ku digjen mbeturinat për ngrohje, etj., si rezultat i mosvendosjes së sistemit të integruar për menaxhimin rajonal të mbeturinave dhe mungesës së vullnetit politik për t'u marrë me dimensionet sociale dhe politike të problemit³³.

IV.2. Burimet e ujit dhe drejta e ujit

Sipas të dhënave, rreth 2% e territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është nën sipërfaqen e ujit. Ka rreth 35 lumenj dhe 53 liqene natyrore dhe artificiale. Prapëseprapë, uji është një nga burimet natyrore më të rrezikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut për arsytet në vazhdim:³⁴

- gjatë periudhës së kaluar janë filtruar vetëm 3-5 % e të gjithë ujërave të zeza që përfundojnë në lumenj dhe liqene,
- thatësi i katastrofale e shkaktuar nga kushtet e këqija klimatike, por edhe nga faktori njeri (lëshimi i akumulimeve për prodhimin e energjisë elektrike)³⁵,
- mosrespektimi i minimumit biologjik të hidrocentraleve të vogla që u ndërtuan³⁶

Problemi me zvogëlimin dhe ndotjen e burimeve ujore në vendin tonë mund të çojë më tej në zvogëlimin e numrit të lumenjëve të pastër malorë, zhdukjen e specieve bimore dhe shtazore endemike, shkatërrimin e habitateve bregore, rrezikimin e shëndetit të popullatës së cilës i privohet e drejta për t'u furnizuar me ujë të pastër.

Ligji aktual për ujin si objektiva kryesore përcakton disponueshmërinë e sasisë së mjaftueshme të ujit cilësor, në pajtim me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të ujit të pijshëm dhe prodhimit të ushqimit për nevojat e bujqësisë, industrisë, nevojave të hidrocentraleve, për nevojat e parqeve dhe hapësirat tjera publike, turizmit, lundrimit dhe për nevoja tjera; mbrojtjen, konservimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të burimeve ujore në dispozicion; përmirësimin e gjendjes së tokës bregore, ekosistemetve ujore dhe ekosistemeve të varura nga uji; mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor përmes shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm të ujit; zvogëlimin progresiv të shkarkimeve të dëmshme dhe eliminimin gradual të emetimeve të materieve dhe substancave të rrezikshme në ujë; zbutjen e pasojave nga veprimet e dëmshme të ujit dhe mungesës së ujit; si dhe mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës, ekosistemeve ujore dhe biodiversitetit dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut.

Fenomenet dhe rastet e shqyrtuara për qëllimet e këtij studimi tregojnë se këto prioritete ligjore nuk janë të mbrojtura në mënyrë adekuate dhe shpesh nuk sigurohet disponueshmëria e tyre, që ngjall dyshime për prapavijë korruptive. Këtu përfshihen:

33 http://dzm.mk/Uploads/1_Joint_report_on_air_quality_2019-LQ_updated2_REDUCE_FINALE.pdf faqe 42

34 <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/B4D3EB5A8F678A4B92A9A4938BB2A3AE.pdf#page=2>

35 <https://www.slobodenpecat.mk/hidrocentralite-se-iskluchuvaat-za-da-se-spasat-ezerata-i-rekrite/>

36 <https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/12/broken-rivers-MK.pdf>

- **Procedurat për dhënien e koncesioneve dhe lejeve për hidrocentralet e vogla, si pjesë e strategjisë energjetike të shtetit për burime të ripërtërijshme të energjisë.**

Ndërtimi i hidrocentraleve të vogla paraqet sferë me rrezikshmëri të lartë korrupsioni në fushën e mjedisit jetësor, që shkaktohet nga mungesa e kontrollit adekuat të zbatimit të ligjeve dhe obligimeve të subjekteve kur bëhet fjalë për ndikimin e projekteve të caktuara mbi mjedisin jetësor. Rreziku detektohet në domenin e dhënies së lejeve për ndërtim të hidrocentraleve të vogla shkaku i zbatimit jo të përpiktë të procedurave ligjore për pjesëmarrjen e publikut³⁷ dhe (mos)zbatimin e vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor. Për prapavijë korruptive³⁸ raportojnë edhe shumë dokumente të organizatave ndërkombëtare³⁹

- **Procedurat për dhënien e koncesioneve për eksploitim të rërës së shtretërve të lumenjve dhe zhavorrit.**

Vërehet dhënie jotransparente e lejeve.⁴⁰ Poashtu nuk respektohet parimi për pjesëmarrjen e publikut dhe shkalla e tolerancës për veprimet në shtretërit e lumenjve, çrregullimet në bregun e lumit, çrregullimet e ujërave nëntokësore, habitateve të botës gjalore në rrypin bregor me dhënien e koncesioneve për eksploitim të rërës dhe zhavorrit.⁴¹ Sqarimi i autoriteteve është se rregullohet shtrati i lumit për shkak të rrezikut nga vërshimet.⁴²

- **Ndotja e rrjedhave ujore mbitokësore dhe nëntokësore.**

Me lëshimin e pakontrolluar të ndotësve në rrjedha uji nga subjekte aktive afariste (fabrika, miniera), si dhe nga pika delikate ekologjike, gjegjësisht mbeturina historike (si p.sh. deponia e Jugohromit⁴³, lindanit dhe zhiva në ujërat nëntokësore).

IV.3. Menaxhimi i pyjeve

Nga hapësira e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut prej 2,5 milionë hektarëve, hapësirat pyjore mbulojnë 949,329 hektarë ose 37 përqind nga territori i vendit. Pyjet në pronësi shtetërore mbulojnë gati 89 përqind të hapësirës së përgjithshme me pyje, ndërsa pjesa e mbetur janë parcela të vogla në pronësi private.⁴⁴

37 https://d20uvy59p0dg6k.cloudfront.net/downloads/hidro_v6_webr.pdf

38 <https://www.radiomof.mk/nema-gragjanin-vo-makedonija-koj-ne-go-povrzuva-zagaduvanje-to-so-korupcija-konferencija-na-zelen-institut/>

39 https://bankwatch.org/press_release/north-macedonia-complaint-challenges-unfair-subsidy-advantages-for-hydropower

40 <https://florozon.org.mk/downloads/investigative-stories/04/Privatizacija-na-prirodna.pdf>

41 <https://prizma.mk/pesochna-treska-gi-razjaduva-rekite/?fbclid=IwARIZOpw6rHSrO95sgFGwz-RKrwvu-1DUvcBALR5IHRIXOGXlizsporuAMDYs>

42 http://dzt.mk/Uploads/65_RU_Dodeluvanje_vodno_pravo_2019_KOMPLET_REDUCED.pdf

43 <https://www.slobodenpecat.mk/otrovite-kaj-jegunovcze-slobodno-se-vleva-vo-vardar/>

44 <http://www.mkdsumi.com.mk/zasumite.php?s=1>

Ligji për pyjet është miratuar në vitin 2016 dhe ai parasheh edhe ndalesat për shkretërizimin dhe shpyllëzimin e pyjeve, si dhe për ridestinimin e përhershëm të tokës pyjore. Me këtë ligj ndalohet prerja jolegale, gjegjësisht prerja që nuk është aprovuar si masë e rregullt për ripërtrirjen e pyllit në dokumentet e planifikimit, si dhe prerja e llojeve të rralla dhe të mbrojtura të drunjëve. Banorëve të fshatrave përreth u lejohej përdorimi i drunjëve për nevoja personale, por sasia e masës së drurit të prerë në pyll shtetëror nuk guxon të tejkalojë më shumë se 10 metër kub për një vit kalendarik.

Sipas Global Forrest Watch⁴⁵, që nga viti 2001 deri më sot nga prerja joligjore vendi ka humbur rreth pesë përqind të pyjeve me të cilat disponon, e ky trend vazhdon⁴⁶ për shkak të angazhimit të pamjaftueshëm të institucioneve kompetente për t'u ballafaquar me këtë dukuri, edhe përkundër indikacioneve për korrupsion të mundshëm. Nga të dhënat në dispozicion për vitin 2019, shkatërrimi i pyjeve viteve të fundit ka trend rritës⁴⁷. Sipas nenit 226 të Kodit Ligjor, degradimi i pyjeve paraqet vepër penale⁴⁸.

Si sfera më të rrezikshme për korrupsion në fushën e menaxhimit të pyjeve⁴⁹ konsiderohen këto në vazhdim:

- Kontrolli i pamjaftueshëm institucional i vjedhjes së drunjëve dhe kontrolli i dobët i prejes së drunjëve nga ana e subjekteve të angazhuara si koncesionerë nga NP Pyjet Shtetërore⁵⁰;
- Realizimi i dispozitave nga marrëveshjet për koncesion lidhur me ndërtimin e hidrocentraleve të vogla ose të hapësirave koncesionare të minierave, kur koncesionerit i lejohej të prejë pyllin për të ndërtuar infrastrukturën dhe rrugicat për akses⁵¹

Mbrojtja e pyjeve nominalisht i përket resorit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU). Edhe pse pyjet dhe sistemet pyjore janë pjesë e hapësirave natyrore, vendbanim i llojeve të rëndësishme bimore dhe shtazore dhe pjesë e rëndësishme e zonave të mbrojtura, që paraqesin sfera nga fushëveprimi i MBPEU, mbrojtja e pyjeve si eko-sisteme dhe trajtimi i tyre si resurse që mirëmbahet dhe eksploatohen rrallë janë veprime të koordinuara, që reflektohet edhe në degradimin e gjendjes së fondit të pyjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

45 <https://www.globalforestwatch.org/map/country/MKD/?mainMap=eyJzaG93QW5hbHlzaXMiOn-RydWV9&map=eylwIjoiZSIsIjEiOiJ5Iiwil6lkoilClzIjoiailsljQiOiJaliwiNSI6IiClCI2IjoiNSIsljciOiI-wliwiY2VudGVyIjpb7ImxhdCl6NDEuNjAxMjAyNjcyNjIiNTQslmxuZyI6MjEuNzMwOTUwMzU1M-DExNjZfSwiem9vbSI6Ny40OTgwNzgzMDY3OTQ4MTEslmNhbkJvdW5kIjpmYWxzZX0%3D>

46 <http://eurothink.mk/wp-content/uploads/2021/02/CIP-FINAL-Izvestaj-Drvokradci-AN.pdf>

47 <https://prizma.mk/nelegalnata-secha-gi-unishtuva-antichkite-balkanski-shumi/>

48 <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%B-D%D0%B8%D0%BA-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BD-%D1%82%D0%B5%D0%BA%D1%81%D1%82.pdf>

49 <http://eurothink.mk/wp-content/uploads/2021/02/CIP-FINAL-Izvestaj-Drvokradci-%D0%9C%D0%9A.pdf>

50 O6_Marina Malis Sazdovska.pdf (mes.org.mk)

51 <https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2017/12/broken-rivers-MK.pdf>

IV.4. Zonat e mbrojtura

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka tre parqe nacionale ose gjithsej 86 zona me shkallë të ndryshme mbrojtjeje, që mbulojnë 230.083 hektarë ose rreth 8,9 % nga territori i vendit, prej të cilave parqe nacionale janë rreth 4,4 % të territorit.⁵² Në vend ekzistojnë dy zona të shpallura si zona të mbrojtura në pajtim me detyrimet nga Konventa për mbrojtje të habitateve ujore me rëndësi ndërkombëtare për mbrojtje të shpendëve ujorë (Ramsar)⁵³ - Liqeni i Prespës (1995) dhe Liqeni i Dojranit (2007). Liqeni i Ohrit nga viti 1979 është në listen e zonave të trashëgimisë botërore të UNESCO-s⁵⁴.

Si fusha më të rrezikshme për korrupsion në sferën e zonave të mbrojtura⁵⁵ cilësohen, si më poshtë:

- **Numri i madh i ndërtimeve të egra në zonat e mbrojtura** të rajonit të Ohrit, që përfshin komunat e Ohrit, Strugës dhe Debërcës, edhe përkundër vërejtjeve të UNESCO-s dhe përpjekjeve të shumta deklarative të pushtetit⁵⁶
- **Urbanizimi i zonave të mbrojtura** - rasti me "Studençishko Bllato"⁵⁷ pranë Liqenit të Ohrit. Për Parkun Nacional të Mavrovës më indikativ është rasti me ndërtesat e Pellagonia Gostivar në fshatin Mavrovë⁵⁸
- **Mosmiratimi i ligjeve për shpallje dhe rishpallje të parqeve nacionale** (Mavrova⁵⁹, Mali Sharr) ose opstruimi i realizimit të strategjive për mbrojtje, të bazuara në kërkesat e UNESCO-s⁶⁰ (Liqeni i Ohrit)
- **Dhënia e koncesioneve në zona rreptësisht të mbrojtura** dhe zona që do të duhej të jenë të mbrojtura në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe vazhdimi i marrëveshjeve të skaduar për koncesion për centralet e vogla hidro-elektrike (HEC) në parqet nacionale (Mavrovë, Pelister), si dhe i dhjetra tjerave në zona që pritet të shpallen të

52 <https://www.moepp.gov.mk/wp-content/uploads/2014/12/%d0%9d%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0%d0%bb%d0%bd%d0%b0-%d1%81%d1%82%d1%80%d0%b0%d1%82%d0%b5%d0%b3%d0%b8%d1%98%d0%b0-%d0%b7%d0%b0-%d0%b7%d0%b0%d1%88%d1%82%d0%b8%d1%82%d0%b0-%d0%bd%d0%b0-%d0%bf%d1%80%d0%b8%d1%80%d0%be%d0%b4%d0%b0%d1%82%d0%b0-2017-2027.pdf>

53 <https://www.iucn.org/theme/water/our-work/thematic-work/wetlands>

54 Konventa e UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë botërore të kulturës dhe natyrës, 1972

55 <https://www.dw.com/mk/%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D1%82%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%BE-%D0%B1%D0%B8%D0%B7%D0%BD%D0%B8%D1%81-%D0%BC%D0%B0%D1%84%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%B3%D0%BE-%D1%81%D0%B8%D0%BB%D1%83%D0%B2%D0%B0-%D0%BE%D1%85%D1%80%D0%B8%D0%B4/a-49603302>

56 <https://prizma.mk/ohrid-go-brani-unesko-statusot-so-rekordi-vo-divogradbi/>

57 https://ohridsos.files.wordpress.com/2018/05/d0b4d0b5d0bad0bbd0b0d180d0b0d186d0b8-d198d0b0_d0b7d0b0-d0b7d0b0d188d182d0b8d182d0b0-d0bdd0b0-d0b5d0bad0bed181d0b8d181d182d0b5d0bcd0be.pdf

58 <https://irl.mk/betonizatsia-na-mavrovo/>

59 <https://meta.mk/eko-svest-bara-zakon-za-upravuvanje-so-nacionalniot-park-mavrovo-i-stopiran-je-na-site-infrastrukturni-aktivnosti/>

60 <https://vlada.mk/node/23890?ln=mk>

mbrojtura për shkak të veçorive të tyre natyrore, biologjike dhe peizazhore, që është në kundërshtim me nenin 75 të Ligjit për mbrojtje të natyrës⁶¹

IV.5. Dhënia e lejeve për shfrytëzim, respektivisht eksploitim

Leje të integruara ekologjike

Për dhënien e lejeve të integruara ekologjike të kategorisë A (LIE) për kapacitetet më të mëdha industriale, kompetente është Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH), ndërsa lejet e integruara ekologjike të kategorisë B i japin komunat, të cilat japin pëlqim edhe për kapacitetet që gjenden në territorin e tyre, e për të cilat nevojitet LIE-A. Përmbajtjet e lejeve janë përcaktuar me Ligjin e mjedisit jetësor dhe me akte nënligjore, dhe ato parashohin detyrime për instalimin e kontrollit të emetimeve, si dhe sigurojnë zbatimin e teknikave më të mira në dispozicion, në mënyrë që të ketë ndikim më të vogël negativ mbi mjedisin jetësor.

Kapacitetet industriale e kanë obligim ligjor vetë të kryejnë monitorim të emetimeve të tyre dhe rezultatet e matjeve t'ia dorëzojnë organit kompetent shtetëror (MMJPH), ndërkaj Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor (ISHMJ) e ka për detyrë të kryejë inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme për të mbikëqyrë respektimin e detyrimeve nga subjekti përkatës. Ky sistem në praktikë ka treguar dobësi të shumta: nga matje "të përshtatshme" të emetimeve⁶² kur është zvogëluar procesi prodhues, e me atë edhe koncentrimi i ndotësve të emituar, angazhimi i laboratorëve privatë si nga ndotësit ashtu edhe nga inspektionet e mjedisit jetësor për shkak të mosakreditimit të Laboratorit Shtetëror dhe konfliktit potencial të interesave (angazhimi i laboratorit privat t'i kontrollojë matjet te klienti i tij etj.), e deri te dhënia e lejeve të integruara ekologjike ku lejohen vlera më të larta emituese të ndotjes (rasti me fabrikën në Koçan, Pejper Mill)⁶³ ose pëlqimin për elabore të NMJ lidhur me magazinimin e paligjshëm të materieve potencialisht të rrezikshme (rasti Remondis)⁶⁴.

Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit për nevojat e planifikimit strategjik të luftës kundër korrupsionit, në kuadër të temës së Sfidave që vijnë nga ndikime tjera të jashtme në procedurat për dhënien e vendimeve, lejeve, marrëveshjeve për koncesion dhe

61 <https://www.moepp.gov.mk/wp-content/uploads/2014/10/%d0%97%d0%90%d0%9a%d0%9e%d0%9d-%d0%97%d0%90-%d0%97%d0%90%d0%a8%d0%a2%d0%98%d0%a2%d0%90-%d0%9d%d0%90-%d0%9f%d0%a0%d0%98%d0%a0%d0%9e%d0%94%d0%90%d0%a2%d0%90.pdf>

62 <https://www.radiomof.mk/drzhavata-ne-izdvojuva-pari-za-laboratorija-shto-kje-kontrolira-zagaduvachi/>

63 <https://www.slobodenpecat.mk/pejper-mil-truel-i-so-polabava-dozvola/>

64 <https://www.vecer.press/%D1%80%D0%B5%D0%BC%D0%BE%D0%BD%D0%B4%D0%B8%D1%81-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%81%D0%BE%D0%BD-%D0%BF%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%BF%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5%D1%82%D0%BE-%D0%B-D%D0%B0-%D0%B8%D0%BD/>

dokumente tjera në sektorin e mjedisit jetësor, ndër të tjera, thekson “ndikimet politike dhe presionet nga sektori privat për të vonuar zbatimin e detyrimit ligjor lidhur me posedimin e lejeve ekologjike dhe dokumenteve tjera në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor”.

Lejet për shfrytëzimin e ujit, rërës dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjve

Rregullorja e Ujit nuk është e plotë, gjegjësisht Ligji për ujërat dhe Strategjia Nacionale e Ujërave (2011-2041) janë miratuar, por deri më tani nuk janë miratuar një numër i akteve nënligjore, si ekonomia e ujërave dhe planet e menaxhimit të pellgjeve lumore, megjithëse është një detyrim që buron nga ky ligj, ndërsa ato akte nënligjore duhet të mundësojnë zbatimin e ligjit dhe strategjisë.

Shumica e përgjegjësive për menaxhimin e Ligjit për ujërat janë në kompetencë të MMJPH, ndërsa pjesa që është në kompetencat e vetëqeverisjes lokale përfshin sigurimin e shërbimeve komunale, mbrojtjen nga përmbytjet dhe sigurimin e ujit cilësor të larjes, por mungojnë mekanizma për bashkëpunim të ndërsjellë dhe në praktikë ekziston një zonë gri në të cilën detyrimet ligjore dyfishohen ose nuk përmbushen. Të drejtat e ujit, përkatësisht lejet e shfrytëzimit të ujit duhet të jepen në bazë të planit për zonën përkatëse, mirëpo, duke pasur parasysh se nuk ka asnjë plan, është e paqartë se në çfarë baze jepen lejet dhe si MMJPH kujdeset për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e regjimit të ujit, pa ekzistencën e instrumenteve konkrete. Kjo situatë, përveç që është bazë për arbitraritet në dhënien e lejeve, nuk garanton se do të arrihen objektivat e Ligjit për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e burimeve të ujit të disponueshëm përmes shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm.⁶⁵

Në praktikë, përveç akteve nënligjore të pamiratuara lidhur me administrimin e ujit dhe mosrespektimin e duhur të Ligjit për ujin, krijohen parakushte për arbitraritet në dhënien e lejeve⁶⁶. Kjo do të thotë se vëhet në pikëpyetje disponueshmëria e një sasive të mjaftueshme të ujit cilësor, kryesisht për pirje, dhe më tej për nevoja të tjera – bujqësi, industri, nevoja hidroenergjetike, turizëm, lundrim, rekreacion dhe nevoja tjera.⁶⁷

Një shembull për këtë është dhënia e lejeve për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla, për të cilat tashmë janë dhënë koncesione. Koncesionet i jep Qeveria, me propozim të Ministrit të Mjedisit Jetësor. Legjislacioni i mjedisit jetësor parashikon që strategjitë e zhvillimit të energjisë dhe burimet e ripërtijëshme të energjisë t’i nënshtrohen procedurës së vlerësimit strategjik të ndikimit të tyre mbi mjedisin jetësor, por për shkak të mungesës

65 <https://iks.edu.mk/wp-content/uploads/2020/12/%D0%9A%D0%B0%D0%BA%D0%BE-%D0%B-4%D0%B0-%D1%98%D0%B0-%D0%BA%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B8%D0%BC%D0%B5-%D0%B8-%D0%B7%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B8%D1%82%D0%BC%D0%B5-%D0%B2%D0%BE%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%B0.pdf>

66 Po aty

67 Po aty

së një dokumenti referues strategjik/planifikues nga sfera e ujit, nuk është e qartë si vlerësohen ndikimet mbi mjedisin jetësor.

Strategjia e Strategjia e Zhvillimit të Energjetikës e Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2040 inkurajon ndërtimin e hidrocentraleve të vogla, por Vlerësimi Strategjik i Ndikimit në Mjedisin Jetësor⁶⁸ nxjerr në pah pasojat negative të ndërtimit të tyre. Në Raportin e Strategjisë Energjetike për VSNMJ thuhet: “Nga numri i lokacioneve të planifikuara, mund të konstatohet se këto objekte infrastrukturore (HEC-et e vogla) për shfrytëzimin e ujit paraqesin një kërcënim të madh për natyrën. Aq më tepër duke pasur parasysh se përfitimet ekonomike janë shumë të vogla jo vetëm për popullsinë, por edhe për ekonominë. Gjegjesisht, të gjithë HEC-et e vogla janë planifikuar në degë të vogla lumenjsh, zakonisht në pjesët e sipërme të pellgjeve të tyre, ku rrjedhat janë të vogla dhe cenueshmëria e terrenit natyror dhe ekosistemeve është shumë e lartë. Për më tepër, duke pasur parasysh vetëdijen e ulët ekologjike në zbatimin e masave për mbrojtjen dhe restaurimin e shtretërve të lumenjve dhe pellgjeve të tyre, mund të konstatohet se ekziston nevoja për të rishikuar lokacionet e mundshme për ndërtimin e HEC-eve të vogla dhe forcimin e kontrollit mbi dhënien e koncesioneve.⁶⁹ Sidoqoftë, ky vlerësim neglizhohet nga dhënia e vazhdueshme e koncesioneve për hidrocentrale të vogla dhe vazhdimi i marrëveshjeve për koncesionet aktuale, madje edhe ato brenda zonave të mbrojtura⁷⁰.

Në Strategjinë Nacionale për Mbrojtjen e Natyrës 2012–2027, ndërtimi i hidrocentraleve të vogla vlerësohet si një shkallë e lartë kërcërimi ndaj vlerave hidrologjike dhe me ndikim kumulativ.⁷¹

Për shkak të faktit se këto janë projekte me kapacitet të vogël, hidrocentralet e vogla aprovohen pa ose vetëm me një vlerësim të pjesërishtëm të ndikimit mbi mjedisin jetësor, sepse vlerësohet se kanë ndikim të ulët ekologjik. Në kuadër të Ministrisë ekziston Sektori i Ujërave dhe brenda tij ekziston edhe një Departament i të Drejtës së Ujërave, i cili, sipas faqes zyrtare të Ministrisë, është përgjegjës për përgatitjen e akteve nënligjore lidhur me procedurën për dhënien e të drejtave të ujit dhe koncesioneve. Ky departament organizon dhe merr pjesë në procedurën për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e ujit, shkarkimin e ujit dhe nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit, si dhe për dhënien e pëlqimeve për administrimin

68 Po aty

69 * https://www.economy.gov.mk/Upload/Documents/SEA%20FINAL_MK%20Dek%202019.pdf

70 <https://iks.edu.mk/wp-content/uploads/2020/12/%D0%9A%D0%B0%D0%BA%D0%BE-%D0%B4%D0%B0-%D1%98%D0%B0-%D0%BA%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B8%D0%BC%D0%B5-%D0%B8-%D0%B7%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B8%D1%82%D0%BC%D0%B5-%D0%B2%D0%BE%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%B0.pdf>, ctp 22

71 <https://www.moep.gov.mk/wp-content/uploads/2014/12/%d0%9d%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0%d0%bb%d0%bd%d0%b0-%d1%81%d1%82%d1%80%d0%b0%d1%82%d0%b5%d0%b3%d0%b8%d1%98%d0%b0-%d0%b7%d0%b0-%d0%b7%d0%b0%d1%88%d1%82%d0%b8%d1%82%d0%b0-%d0%bd%d0%b0-%d0%bf%d1%80%d0%b8%d1%80%d0%be%d0%b4%d0%b0%d1%82%d0%b0-2017-2027.pdf>

e ujit. Poashtu merr pjesë në zbatimin e procedurës për dhënien e koncesioneve. Në këtë sektor ekziston Departamenti për Koncesione dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. Në përshkrimin e kompetencave thuhet se ky departament është përgjegjës për organizimin e aktiviteteve lidhur me përgatitjen dhe zbatimin e procedurës për dhënien e koncesioneve, bashkëpunon dhe koordinon bashkëpunimin ndërmjet organeve kompetente të administratës shtetërore që parasheh Ligji për ujërat dhe Ligji për koncesione dhe formave tjera të partneritetit publik-privat. Poashtu është përgjegjës për përgatitjen e akteve nënligjore lidhur me procedurën për dhënien e të drejtave të ujit dhe dhënien e koncesioneve për shfrytëzimin e ujit. Koordinon edhe procedurën për dhënien e lejeve lidhur me procedurën e koncesionit.

Siç mund të shihet nga kompetencat, një organ i njëjtë, gjegjësisht të njëjtët punonjës në këto dy departamente – së pari përgatisin rregullore dhe akte tjera nënligjore të miratuara nga vetë Ministria, të cilat përcaktojnë procedurat dhe kushtet në të cilat jepen koncesionet e ujit, dhe pastaj marrin pjesë në procedurën për dhënien e të drejtave të ujit dhe të koncesioneve, e në fund japin leje për eksploatimin e rërës, respektivisht kanë autorizimin për të dhënë leje përdoruesëve komercialë të të drejtave të ujit, që zakonisht janë subjekte afariste të regjistruara për prodhimin e energjisë elektrike në hidrocentrale të vogla dhe kompani që marrin koncesione për eksploatimin e rërës. Me një hierarki të këtyllë, në këtë njësi organizative të Ministrisë ka një përqendrim të kompetencave në një pikë vendosjeje dhe kjo paraqet një potencial jashtëzakonisht të lartë për korrupsion.

Në Ligjin për ujërat (neni 131) parashihet ndalesë e përgjithshme për eksploatim të zhavorrit, rërës dhe gurit nga koritat dhe brigjet e sipërfaqeve ujore (rrjedhat e ujit, liqenet dhe rezervuarët), gjë që përkeqëson regjimin ekzistues të ujit, shkakton procese erozioni dhe kufizohet ose pamundësohet shfrytëzimi i ujërave. Megjithatë, si përjashtim, eksploatimi është i mundur si një masë rregulluese (Ligji për ujërat, neni 142, i cili ndërlihet me nenin 26 – Përvetësimi i të drejtave të ujit), në bazë të një koncesioni të lëshuar, të një lejeje të dhënë ose në përputhje me kushtet në atë leje, të cilën poashtu e jep sektori i njëjtë i ujit pranë MMJPH. Pjesa më e madhe e materialit të eksploatuar përdoret për shitje, ndërsa një pjesë e vogël përdoret për rregullimin e shtretërve të lumenjve, mirëpo nuk janë paraparë masa mbrojtëse nga gërmimet ilegale (fshati Konjar i Epërm, Konjar i Mesëm). Kjo çon në shkatërrimin e shtretërve të lumenjve, mbështet proceset erozive dhe çon në përmytje, duke rrezikuar kështu shëndetin dhe pronën e popullatës.

Vlerësimi i KSHPK për rreziqet e korrupsionit në pjesën e Sfidave, që burojnë nga korniza ligjore dhe institucionale e procedurave për dhënien e lejeve ekologjike dhe dokumenteve tjera, përfshin edhe praktikën e mosndëshkimit për sjellje korruptive lidhur me (mos) zbatimin e legjislacionit.

Leje për eksploatimin e pyjeve

Mbrojtja e pyjeve në RMV rregullohet me Ligjin për pyjet. Pyjet shtetërore dhe toka pyjore menaxhohen nga shteti përmes institucioneve në vijim: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë

dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU); Inspektorati Shtetëror për Pylltari dhe Gjueti, si organ pranë MBPEU, Policia Pyjore, si sektor pranë MBPEU, Ndërmarrja Publike “Pyjet Nacionale”, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPP) dhe Shoqata Nacionale e Pronarëve të Pyjeve Private (SHNPPP). Ekzistojnë dy lloje të pronësisë së pyjeve – publike dhe private. Pyjet në pronësi publike menaxhohen nga NPPN, pyjet në zonat e mbrojtura menaxhohen nga administratat e parqeve nacionale, ndërsa pyjet private poashtu menaxhohen nga ndërmarrja publike, sepse pronarët e pyjeve private duhet të marrin leje për çdo aktivitet që ndërmarrin në pyjet e tyre. Nga sipërfaqet totale nën pyje, pjesa e pyjeve në pronësinë e shtetit është 89.1%, dhe në pronësi private 10.9%.

Në përgjegjësi të Ndërmarrjes Publike “Pyjet Nacionale” është të planifikojë shfrytëzimin e pyjeve dhe për atë qëllim përgatiten plane vjetore, por obligimi i Pyjeve Nacionale është vetëm shënimi i trungjeve, ndërsa prerja, furnizimi dhe transporti kryhen nga kompani private me tender. Raportet nga terreni flasin për abuzime me lejet nga koncesionarët që shfrytëzojnë pyjet në një zonë të caktuar, duke tejkaluar sasinë e prerjes së kontraktuar të drurit dhe po këto raporte thonë se ekziston kontrolli i dobët dhe joefikas mbi mënyrën dhe vëllimin e eksploatimit të pyjeve nga koncesionarët, së bashku me prerjet ilegale⁷². Ekspertët gjithashtu flasin për problemin e prerjeve ilegale, ku lidhja midis autoriteteve përgjegjëse për luftimin e këtij lloji të krimit dhe prerësve, përkatësisht grupeve të organizuara kriminale që merren me prerjet ilegale, është një nga format më të theksuara dhe të dukshme të korrupsionit, kur bëhet fjalë për shkatërrimin e burimeve natyrore. Sipas të dhënave nga hulumtimi i Eurothink, të botuar në fund të vitit 2020, ka disa faktorë që tregojnë ekzistencën e fenomeneve korruptive në këtë sektor: kërkesa më e lartë për dru zjarri nga kapacitetet e NP Pyjet Nacionale; standardi i ulët i një pjese të madhe të popullsisë që përdor dru zjarri që e bën tregun e druve të zjarrit në tregun e zi shumë të fuqishëm dhe tërheqës për elementin kriminogjen; si dhe dobësitë në kontrollin e institucioneve për prezencë korrupsioni. Janë tre institucione përgjegjëse për kontrollimin e gjendjes me prerjet ilegale: Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Pyjeve pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Gjuetisë, por kompetencat e tyre në disa pjesë ndeshen e dyfishohen, ndërsa diku nuk kanë as pika prekëse, duke lënë hapësirë për mungesë kontrolli dhe keqpërdorime të mundshme. Ristrukturimi i ngadalshëm i shtetit drejt shfrytëzimit të burimeve të gjelbra të energjisë krijon parakushte që prerjet ilegale të jenë shumë të përhapura dhe të marrin një dimension social, ndërsa joefikasiteti në luftën kundër këtij fenomeni mund të jetë tregues se kjo tolerohet me vetëdije nga institucionet kompetente.

72 <http://eurothink.mk/wp-content/uploads/2021/02/CIP-FINAL-Izvestaj-Drvokradci-%D0%9C%D0-%9A.pdf> “Sipas Ligjit për prokurime publike tenderët fitohen në bazë të çmimit më të lirë të ofruar, madje edhe më lirë se çmimi në treg – për shembull, prerja e drunjëve ka çmim prej 250 denarëve për meter kub, edhe pse sipas dokumentacionit të NPPN çmimi është 360 denarë për meter kub, e pastaj ndryshimi plotësohet me sasi shtesë të drunjëve për ngrohje. Sigurisht që për këtë nuk ka të dhëna publike dhe për këtë arsye është i domosdoshëm një kontroll më i rreptë, sidomos në terren”.

Koncesionet në zonat e mbrojtura

Dhënia e koncesioneve dhe lejeve të ujit për hidrocentrale të vogla përshkruhet në nënkapitullin: Leje për eksploatimin e ujit, rërës dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjve. Praktika në Republikën e Maqedonisë së Veriut dëshmon se një pjesë e konsiderueshme e koncesioneve të dhëna janë në zona të mbrojtura me ligj ose në zona që duhet të mbrohen, gjegjësisht që janë shpallur parqe nacionale për periudhën në vijim. Një shembull i tillë është Mali Sharr, i cili është në fazën përfundimtare për t'u shpallur parku i katërt nacional në vend, e në territorin e të cilit, sipas ndarjes së propozuar në zona, janë planifikuar 25 hidrocentrale të vogla (disa tashmë janë ndërtuar), ndërsa në parkun nacional (PN) Mavrovë⁷³ ekziston një plan për ndërtimin e 19 HEC-eve të vogla.

Edhe pse propagon mbrojtje nga ndërtimi i hidrocentraleve të vogla në vend, Strategjia e përmendur për zhvillimin e energjetikës së RMV deri në vitin 2040⁷⁴ rekomandon të mos merren parasysh projektet e hidrocentraleve në zonat e mbrojtura. “Në Programin për zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit të Energjetikës të Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2040, rekomandohet që gjatë përzgjedhjes së projekteve specifike të anashkalohen zonat e mbrojtura nacionale, si dhe zonat e propozuara për mbrojtje (Rrjeti Nacional i Zonave të Mbrojtura, Emerald, Natura 2000)” (faqe 136).

Në programin e punës së Qeverisë 2020–2024 thuhet se është vendosur një ndalesë për ndërtimin e hidrocentraleve të reja të vogla në zonat e mbrojtura dhe në parqet nacionale⁷⁵. Sidoqoftë, në fund të vitit 2020, Qeveria vazhdoi marrëveshjet e koncesionit për të paktën dy hidrocentrale të vogla në zonën rreptësisht të mbrojtur të Parkut Nacional Mavrovë, afër fshatit Zhirovnicë⁷⁶, të njohur si Zhirovnica 5 dhe 6, të cilat përveç që u kishte skaduar kontrata, gjithashtu shkaktuan protesta të popullsisë lokale, dhe rrjedhimisht leja për ndërtimin e tyre u revokua nga Komuna e Mavrovës dhe Rostushës. KSHPK, duke vepruar në bazë të një parashtrese nga një parti politike dhe një shoqatë ekologjike qytetare lidhur me këto dy hidrocentrale të vogla, koncesionari i të cilave është një kompani ku aksionar është një ish-zëvendës Kryeministër, mbylli çështjet⁷⁷ pasi nuk gjeti asnjë konflikt të interesi për marrjen e koncesioneve lidhur me ndërtimin e hidrocentraleve 5 dhe 6 në fshatin Zhirovnicë.

Megjithatë, KPSHK kërkoi nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut që të “rishikojë ndikimin e ndërtimit të hidrocentraleve të vogla në territorin e Parkut Nacional Mavrovë në pajtim me rekomandimet e Këshillit të Evropës, me theks të veçantë në efektet kumulative” të projekteve të tilla në këtë park. Në vitin 2015, Komiteti i Përhershëm i Konventës së Bernit kërkoi pezullimin e të gjitha projekteve qeveritare

73 <https://www.slobodnaevropa.mk/a/28337393.html>

74 https://www.vicpremier-ekonomija.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/EnergyDevelopment-Strategy_FINAL_Submitted_toGovMK_08.01.2020_clean_zs_sluzben_vesnik_zs_na_web.pdf

75 <https://vlada.mk/node/22525>

76 <https://www.slobodenpecat.mk/mali-hidrocenrali-ke-niknat-i-vo-nacionalniot-park-mavrovo/>

77 https://dksk.mk/fileadmin/user_upload/odluki_2/2019-2611-16_-Odluka_d.pdf

infrastrukturore në Parkun Nacional Mavrovë, veçanërisht të projekteve të planifikuara të hidrocentraleve Boshkov Most dhe Llukovo Pole.⁷⁸

Pavarësisht nga gjetjet e KSHPK në rastin e dy hidrocentraleve të vogla të njohura si Zhirovnica 5 dhe 6, aktivistët ekologjikë vazhdojnë të hedhin dyshime për ekzistencën e lidhjeve korruptive në procedurat për dhënien dhe vazhdimin e koncesioneve për hidrocentralet e vogla.

IV.6. Inspektimi dhe kontrolli

Inspektimi i mjedisit jetësor

Legjislacioni që mbulon kompetencat dhe mënyrën e veprimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Jetësor është jo i plotë sepse legjislacioni evropian nuk është transpozuar plotësisht. Ligji për inspektim⁷⁹ u miratua në vitin 2015, kur u përgatit projektligji për inspektimin e mjedisit jetësor, por ai nuk është miratuar ende, edhe pse raportet e KE për progresin e Maqedonisë së Veriut na rikujtojnë për këtë detyrim nga viti në vit, për të cilën tashmë kemi theksuar më sipër, në kapitullin mbi raportet e Komisionit Evropian për vendin tonë. Aktualisht, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor (ISHMJ) ka 16 inspektorë që punojnë në gjithë territorin e vendit. ISHMJ ka vetëm dy inspektorë të ekonomisë së ujërave⁸⁰. ISHMJ planet mujore dhe vjetore të punës, si dhe raportet gjashtëmujore të punës, ia paraqet Këshillit të Inspektimit, i cili është përgjegjës për punësimin e inspektorëve të rinj dhe dhënien e licencave të punës për inspektorët shtetërorë dhe inspektorët lokalë të mjedisit jetësor. Këshilli i Inspektimit për inspektorët ka miratuar edhe një Kod Etik⁸¹.

Inspektorët komunalë emërohen nga kryetari i komunës dhe raportojnë drejtpërdrejt tek ai/ajo. Studimi i Infocenter⁸² vlerëson se një vendosje e tillë rrit rrezikun për korrupsion. I njëjti hulumtim zbuloi se, për shkak të kompetencave të përcaktuara ngushtë dhe kapacitetit të ekipit, e në disa komuna edhe për shkak të mungesës së një inspektori të çertifikuar komunal (për shembull për shkak të pensionimit ose largimit për një vend të ri pune), inspektimet komunale kanë ndikim të kufizuar, efekt të vogël ose nuk funksionojnë aspak.

78 <http://www.mkd.mk/makedonija/postojan-komitet-na-bernska-konvencija-zabrana-za-izgrad-ba-na-hidrocentralite-boshkov>

79 <https://duinspektorat.mioa.gov.mk/sites/default/files/documents/%D0%97%D0%B0%D0%BA-%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%B8%D0%BD%D1%81%D0%F%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%81%D0%BA%D0%B8%20%D0%BD%D0%B0%D0%B4%D0%B7%D0%BE%D1%80%20%202019.pdf>

80 <https://www.slobodenpecat.mk/intervju-so-ana-petrovska-namesto-rutinski-kontroli-ke-se-fokusirame-na-golemite-zagaduvachi/>

81 <http://dki.gov.mk/wp-content/uploads/2015/03/eticki-kodeks.pdf>

82 <http://nvoinfocentar.mk/wp-content/uploads/2020/04/Izvestaj-za-opstinskite-inspekciski-službi.pdf>

Raporti i auditimit mbi cilësinë e ajrit për periudhën 2017-2019, ndër të tjera, konkludon⁸³ se departamentet e mjedisit jetësor në komuna që kanë kompetencë të japin leje të integruara ekologjike të kategorisë B, e në të njëjtën kohë edhe kryejnë inspektime si rezultat i kapaciteteve të kufizuara, për shkak të vëllimit të detyrave që kanë, mosnjohjes së proceseve tekniko-teknologjike të instalimeve dhe mungesës së pajisjeve teknike, përballen me konflikt interesi, mbingarkesë dhe joefikasitet në funksionimin e tyre.

Në nivel vjetor mesatarja e mjeteve financiare të akorduara për inspektim nga buxhetet e komunave sillet rreth 1%.⁸⁴

Inspektorati Shtetëror inspekton subjektet me leje të integruara ekologjike të kategorisë A, ndërsa inspektorët komunalë të mjedisit jetësor mbikëqyrin instalimet me leje të integruara ekologjike të kategorisë B. Për matjet e emetimeve të këtyre instalimeve, të dy inspektoratet përdorin shërbimet e laboratorëve komercialë, sepse Laboratori Shtetëror pranë MMJPH për dekada me radhë nuk ka akreditimin për metodat matëse të ndotjes së ajrit. Prandaj, inspektorët e mjedisit jetësor nuk kanë një instrument objektiv për testimin e mostrave të marra nga ndotësit industrialë dhe kapacitetet tjera me leje të integruara ekologjike A dhe B, por duhet të kërkojnë shërbimet e laboratorëve të akredituar privatë, për të bërë matjet të cilat më pas duhet të shërbejnë si prova në procedurat gjyqësore. Mundësia e korrupsionit qëndron në faktin se të njëjtët laboratorë si klientë të tyre kanë të njëjtat kapacitete industriale, të cilat i angazhojnë këto laboratorë për shkak të detyrimit ligjor për të monitoruar vetë emetimet e tyre, kështu që mund të ketë një konflikt interesi në vetë laboratorët, të cilët veprojnë në frymë komerciale. Për lidhjen e mundshme midis ndotësve dhe laboratorëve paralajmërohet në disa media, si dhe në raportet e organizatave ndërkombëtare, siç është ai i EUROSAI i përmendur më lartë. Disa nga problemet me të cilat përballet ISHMJ janë: databaza e vjetëruar e lejeve të dhëna të integruara ekologjike A, e lejeve për ruajtjen dhe trajtimin e mbeturinave, elaboratet e aprovuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor me të cilat është punuar, por edhe “verbëria teknologjike” kur i njëjti inspektor ka inspektuar subjektin e njëjtë juridik për vite me radhë⁸⁵.

Kontrolli mbi prerjet e pyjeve

Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Gjuetisë (ISHPGJ) pranë MBPEU kontrollon të gjitha personat juridikë që administrojnë pyjet. ISHPGJ ka disa përgjegjësi, si: kontrolli i përgjithshëm i prerjes së pyjeve, zbatimi i planeve vjetore dhe dhënia e miratimeve për prerje. ISHPGJ te Policia Pyjore (PP) dorëzon parashtresa kundër prerjeve të paligjshme. Për më tepër, PP mbron pyjet në pronësi të shtetit dhe në pronësi private, në pajtim me Ligjin për pyjet dhe rregulloren e punës. PP e ka për detyrë ta ruajë pyllin, të intervenojë,

83 https://dzm.mk/Uploads/56_RU_Kvalitet_na_vozduhot_2017_REDUCED.pdf

84 <http://nvoinfocentar.mk/wp-content/uploads/2020/04/Izvestaj-za-opstinskite-inspekciski-sluzbi.pdf> (faqe 3)

85 <https://www.slobodenpecat.mk/intervju-so-ana-petrovska-namesto-rutinski-kontroli-ke-se-fokusirame-na-golemite-zagaduvachi/>

të parandalojë, të identifikojë dhe arrestojë persona të kapur në flagrancë duke kryer kundërvajtje ose vepra penale në hapësirat pyjore, si dhe të inspektojë të gjitha mjetet me të cilat transportohen lëndë druri dhe produkte tjera pyjore. PP dokumenton personat që transportojnë lëndë druri dhe, nëse nuk kanë dokumentet e duhura, ajo ka të drejtë t'ua konfiskojë automjetet e tyre përkohësisht dhe të paraqesë padi penale kundër shkelësve të ligjit.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është gjithashtu e përfshirë në procesin e luftimit kundër prerjeve të paligjshme, në përputhje me Ligjin për pyjet dhe Kodin Penal. Sipas Kushtetutës, Kodit Penal, Ligjit për kundërvajtje dhe Ligjit për pyje, Ministria e Punëve të Brendshme ka një rol shumë të rëndësishëm në procesin e zbatimit të ligjeve që synojnë mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme nuk ka sektor specifik që merret me krimin ekologjik mbi mjedisin jetësor. Në vitin 2014, MPB filloi aksionin operativ "Gora" (shqip: Mali), në të cilin u ngritën 1334 kallëzime penale kundër 2204 autorëve, dhe u sekuestrua gjithsej 97843 m³ masë drurore. Dëmi material vlerësohet në më shumë se 335 milionë denarë.⁸⁶

Hulumtimet mbi korrupsionin dhe prerjet ilegale sugjerojnë potencialin për korrupsion në dy segmente: porozitetin e kontrollit të transportit të drunjve të prerë në mënyrë të paligjshme, nga vendi ku prehen në pikën ku shiten, dhe në politikën e butë ndëshkuese nga prokurorët publikë dhe gjykatat. Vitin e kaluar, u publikua një studim i Kanal 77 që hetonte raste në të cilat punonjës të institucioneve përgjegjëse për mbikëqyrje, kontroll dhe sanksionim, janë përfshirë në biznesin e prerjeve të paligjshme dhe shitjes e rishitjes së drunjve⁸⁷.

Disa hulumtime tregojnë se ka raste kur, për shkak të kontestit juridiksional të territorit ndërmjet NP 'Pyjet e Maqedonisë' dhe plantacioneve pyjore që janë pjesë e zonës së mbrojtur aktuale ose zonës që do të shpallet e mbrojtur, si dhe për shkak të mungesës së koordinimit të të gjitha institucioneve të prekura, nuk ka plane të përgatitura menaxhimi me burimet, gjë që shkakton rritjen e rrezikut për prerje të pakontrolluar dhe të paligjshme, që për shkak të kapaciteteve të dobëta të organeve të kontrollit dhe mungesës së interesit të autoriteteve kompetente, kalon pa u sanksionuar.

86 <http://eurothink.mk/wp-content/uploads/2021/02/CIP-FINAL-Izvestaj-DrvoKradci-%D0%9C%-D0%9A.pdf>

87 <https://mms.mk/137905/%D0%B4%D0%B8%D0%B2%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%B5%D1%87%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D1%88%D1%83%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BA%D0%BE%D1%80%D1%83%D0%BF%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%BD%D0%B8-%D0%B7%D0%B4%D0%B5%D0%BB/>

IV.7. Përfshirja e publikut si formë kontrolli

Gjatë hulumtimit lidhur me temën e korrupsionit në fushën e mjedisit jetësor dhe shembujve specifikë që prekin publikun (kryesisht popullatën lokale) ose që kontestojnë vendimet e institucioneve kompetente, gjetëm dëshmi të shumta të mungesës së informimit dhe mospërfshirjes në procesin e vendimmarrjes, përkundër detyrimit ligjor për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje. Shembujt që janë hulumtuar tregojnë se publiku shpesh anashkalohet në procesin e vendimmarrjes për çështje në fushën e mjedisit jetësor, e që janë jetike për të, kështu që parimi i informimit dhe përfshirjes në atë proces ose është respektuar vetëm formalisht, pa asnjë substancë, ose është lënë plotësisht pas dore. Publiku i prekur, përkatësisht popullata lokale e prekur nga vendimet e qeverisë në fushën e mjedisit jetësor, të shumtën e rasteve për realizimin e një projekti ka kuptuar vetëm pasi procesi i realizimit të atyre projekteve ka qenë në një fazë të vonshme. Reagimi i publikut zakonisht ka ndodhur vetëm në fazën kur punët ndërtimore në terren kanë filluar dhe përpjekjet e qytetarëve për të thënë fjalën e tyre për atë projekt konkret janë hedhur poshtë nga autoritetet kompetente, duke shpjeguar se reagimi është i vonuar dhe se publiku tashmë ka pasur mundësinë të japë mendimin e vet për këtë çështje, por nuk e ka shfrytëzuar atë mundësi.⁸⁸ Shembuj më eklatantë ku publiku nuk ka qenë i informuar janë rastet ku banorët lokalë kanë kundërshtuar ndërtiminin e hidrocentraleve të vogla të rrjedhave ujore që ata shfrytëzojnë për nevojat e tyre ose për rastet e ndryshimit të lejeve të integruara ekologjike, të cilat mundësojnë prag më të lartë ndotjeje ose përdorimin e një teknologjie tjetër.⁸⁹ Në fshatin Zhirovnice u anashkalua detyrimi për t'u konsultuar me publikun lidhur me dhënien nën koncesion të lumit lokal që kalon nëpërmjet fshatit në drejtim të tre hidrocentraleve të vogla, dhe për këtë banorët kuptuan⁹⁰ në vitin 2018, pasi që kishin filluar punët përgatitore që i paraprinë ndërtimit. Pasi që bashkia e fshatit Zhirovnice kishte qenë kategorike se nuk do të lejojë ndërtim, Qeveria ka shfuqizuar njërin koncesion, ndërsa dy lejet tjera për ndërtim i shpalli të pavlefshme Komuna e Mavrovës dhe Rostushës.⁹¹

88 Në kuadër të pjesës së hulumtimit në terren rreth lidhshmërisë së informimit të publikut me veprime potenciale korruptive në sferën e menaxhimit me ujëra, janë zhvilluar biseda me përfaqësues të popullsisë lokale të fshatrave: Zhirovnice (Komuna Mavrovë-Rostushë), Tursko Rudari (Probishtip), Konjare e Epërme dhe e Mesme (Petrovec), Brodec, Bozovcë (Tetovë) në tokën e të cilave ndërtohen ose planifikohet ndërtimi i hidrocentraleve të vogla. Dëshmitë e tyre, një pjesë e të cilave janë publikuar në portalet e meta.mk dhe slobodnaevropa.mk, janë përdorur edhe për nevojat e këtij hulumtimi.

89 Si në rastin e Pejperll Mill-it në Koçan, që rezultoi me protesta të njëpasnjëshme – inspektim i jashtëzakonshëm nga ISHMJ, gjobë me para dhe mbyllje të fabrikës.

90 <https://www.slobodnaevropa.mk/a/%D0%BD%D0%B5%D0%BC%D0%B0-%D0%B2%D0%BE-%D0%B4%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D0%BB%D1%83%D1%93%D0%B5%D1%82%D0%BE-%D0%B0-%D0%BD%D0%B5-%D0%BF%D0%B0%D0%BA-%D0%B7%D0%B0-%D1%85%D0%B8%D0%B4%D1%80%D0%BE%D1%86%D0%B5%D0%BD%D1%82%D1%80%D0%B0%D0%BB%D0%B8/30059972.html>

91 <https://www.slobodnaevropa.mk/a/%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%84%D0%BB%D0%B8-%D0%BA%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%B8%D0%BD%D1%82%D0%B5%D1%80%D0%B5%D1%81%D0%B8-%D0%BF%D1%80%D0%B8-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D1%80%D0%BE%D0%BA%D0%BE%D0%B2%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D0%BC%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D1%85%D0%B8%D0%B4%D1%80%D0%BE%D1%86%D0%B5%D0%BD%D1%82%D1%80%D0%B0%D0%BB%D0%B8-/30058563.html>

Deri më tani, mënyra në të cilën informohet publiku në procedurën e dhënies së lejeve nga MMJPH, nuk është treguar mjaftueshëm efikase. Në përgjigjen e marrë nga Ministria, sqarohet se brenda shtatë ditëve të punës nga dita e pranimit të kërkesës, kërkesa botohet në të paktën një gazetë ditore që distribuohet në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në ueb-faqen e saj, ndërsa çdo vërejtje duhet të paraqitet në arkivin pranë selisë së ministrisë në Shkup, procedurë që rezultoi e papërshtatshme për përfshirjen e popullatës rurale, ku planifikohet ndërtimi i hidrocentraleve të vogla. Në shumicën e rasteve kur për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla ose për dhënie e koncesioneve për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjve ka rezistencë nga popullata lokale, parashtrohen ankesa se ata nuk janë konsultuar në lidhje me vendimin për të dhënë në shfrytëzim burime vitale nga mjedisi i tyre, posaçërisht kur ekziston mundësia e rrezikimit të së drejtës për qasje në ujë të pijshëm dhe ujë për ujitje. Duhet theksuar se në ueb-faqen e MMJPH nuk ka informacion se sa leje uji janë dhënë, por janë publikuar gjithsej gjashtë kërkesa për shfrytëzim uji për periudhën 2015-2016. Kur pyetëm MMJPH pse nuk publikohen të gjitha të dhënat për lejet e dhëna dhe për konsultimin me publikun, përgjigjja ishte se ato mbajnë evidencë, por se “lejet ngarkohen në portal sipas mundësive teknike. Tani jemi në proces të zhvillimit të një faqe interneti që do të plotësojë nevojat në rritje lidhur me publikimin e dokumentacionit përkatës të të gjitha shërbimeve të MMJPH”.

Si “anashkalohet” konsultimi publik

